



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emë të Allahut, të Gjithëmirësisht, M ë shirues!

40 KËSHILLA PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES FAMILJARE

Muhamed Salih el-Munexhid

Botuar nga: botues privat

SHTËPIA ËSHTË BEGATI	6
PËRBËRJA E SHTËPISË	10
KËSHILLA E PARË: TA ZGJEDHËSH MIRË GRUAN	10
KËSHILLA E DYTË: MUNDOHU TA PËRMIRËSOSH GRUAN	13
KËSHILLA E TRETË: BËJE SHTËPINË VEND KU PËRMENDET ZOTI	15
KËSHILLA E KATËRT: BËJENI SHTËPINË TUAJ VEND ADHURIMI	16
KËSHILLA E PESTË: EDUKIMI FETAR NË FAMILJE	18
KËSHILLA E GJASHTË: DHËNIA RËNDËSI DHIKREVE DHE SUNNETEVE QË KANË TË BËJNË ME SHTËPINË.	19
KËSHILLA E SHTATË: LEXIMI I PANDËRPERË I SURES BEKARE NË SHTËPI ME QËLLIM QË TË LARGOHET SHEJTANI	20
SHKENCAT E SHERIATIT NË SHTËPI	21
KËSHILLA E TETË: MËSIMI I ANËTARËVE TË SHTËPISË	21
KËSHILLA E NËNTË: BËN BIBLIOTEKË ISLAME NË SHTËPINË TËNDE.	25
KËSHILLA E DHJETË: BË NË SHTËPI NJË BIBLIOTEKË AUDIO KASETASH	28
KËSHILLA E NJËMBËDHJETË: FTUARJA E NJERËZVE TË MIRË DHE DIJETARËVE PËR T'JU VIZITUAR NË SHTËPI	30
KËSHILLA E DYMBËDHJETË: MËSOI VENDIMET E FESË QË KANË TË BËJNË ME SHTËPINË	31
JETA FAMILIJARE	36
KËSHILLA E TREMBËDHJETË: DUHET MBAJTUR TUBIME KU DO TË DISKUTOHEN ÇESHTJET FAMILJARE.	36

KËSHILLA E KATËRMBËDHJETË: NUK DUHET TË SHFAQEN MOSPAJTIMET FAMILJARE PARA FËMIJËVE.....	38
KËSHILLA E PESËMBËDHJETË: MOS FUT NË SHTËPI PERSON JOFETAR (AMORAL).....	39
KËSHILLA E GJASHTËMBËDHJETË: DUHET QENË PRECIZ GJAT VËZHGIMIT TË GJENDJES SË ANTARËVE TË FAMILJES.....	41
KËSHILLA E SHTATËMBËDHJETË: DUHET DHËNË RËNDËSI FËMIJËVE TË VEGJËL NË SHTËPI.....	44
KËSHILLA E TETËMBËDHJETË: DUHESH TË JESH I PRERË NË RREGULLIMIN E KOHËS SË GJUMIT DHE DETYRAVE.....	46
KËSHILLA E NËNTËMBËDHJETË:.....	47
VLERËSIMI I PUNËSIMIT TË GRUAS JASHTË SHTËPISË.....	47
KËSHILLA E NJËZET: MBANE SEKRETIN E SHTËPISË.....	51
MORALI NË SHTËPI.....	53
KËSHILLA E NJËZETENJË: PËRHAPJA E BUTËSISË NË SHTËPI.....	53
KËSHILLA E NJËZET E DY: BASHKËPUNIMI NDËRMJET ANTARËVE TË FAMIJES.....	54
KËSHILLA E NJËZET E TRETË: PËRKDHËLJA DHE BËRJA SHAKA ME ANTARËT E FAMILJES.....	55
KËSHILLA E NJËZET E KATËRT: DUHET BËRË REZISTENCË NDAJ MORALIT TË KEQ NË SHTËPI.....	57
KËSHILLA E NJËZET E PESTË: VËNDO SHKOPIN NË ATË VEND QË E SHOHIN ANTARËT E FAMILJES.....	58
VEPRAT E NDALUARA NË SHTËPI.....	60
KËSHILLA E NJËZET E GJASHTË: HYRJA E TË AFËRMËVE QË NUK JANË MAHREM NË SHTËPI KUR NUK ËSHTË BURRI ATY.....	60
KËSHILLA E NJËZET E SHTATË: NDANI GRATË PREJ BURRAVE GJAT VIZITAVE FAMILJARE.....	60

KËSHILLA E NJËZET E TETË: KENI KUJDES PREJ REZIKUT TË VOZITËSIT DHE SHËRBËTORËVE NË SHTËPI.	60
KËSHILLA E NJËZET E NËNTË: NXJERRNI HEMAFRODITËT PREJ SHTËPIE.	60
KËSHILLA E TRIDHJETË: RUHUNI NGA DËMI I TELEVIZORIT.	60
KËSHILLA E TRIDHJETË E NJË: RUHUNI PREJ DËMIT TË TELEFONIT.	61
KËSHILLA E TRIDHJETË E DYTË: DUHET NXJERRË PREJ SHTËPISË TË GJITHA SHENJAT E BESIMEVE TJERA DHE TË ZOTAVE TË TYRE.	61
KËSHILLA E TRIDHJETË E TRETË: NXJERRNI FOTOGRAFITË E GJËRAVE QË KANË SHPIRTË.	61
KËSHILLA E TRIDHJETË E KATËRT: NDALNI PIRJEN E DUHANIT NË SHTËPIT TUAJA.	61
KËSHILLA E TRIDHJETË E PESË: MOS MBANI QEN NË SHTËPI.	61
KËSHILLA E TRIDHJETË E GJASHTË: LARGOHUNI NGA ZBUKURIMI I TEPËRT I SHTËPIVE.	62
RREGULLIMI I SHTËPISË NGA BRENDA DHE JASHTË	62
KËSHILLA E TRIDHJET E SHTATË: DUHET ZGJEDHË VEND DHE PROJEKT TË MIRË PËR SHTËPINË.	62
KËSHILLA E TRIDHJETË E TETË: ZGJIDHE FQIJUN PARA SHTËPISË.	63
KËSHILLA E TRIDHJETË E NËNTË: DUHET DHËNË RËNDËSI PËRMIRËSIMEVE TË NEVOJSHME NË SHTËPI DHE OFRIMIT TË MJETEVE TË REHATISË NË SHTËPI.	65
KËSHILLA E KATËRDHJETË: DUHET DHËNË RËNDËSI SHËNDETIT TË ANTARËVE TË FAMILJES.	66

Falënderimi i takon All-llahut, Atë e falendërojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë nga Zoti që të na mbrojë nga të këqijat e shpirtit dhe veprave tona. Atë që e udhëzon All-llahu, s'ka kush e humbë dhe atë që e humbë s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s'ka të adhuruar përveç All-llahut, i cili është Një i pa rival dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij.

SHTËPIA ËSHTË BEGATI

All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

“All-llahu ua ka bërë shtëpiat e juaja vendbanim”

Ibni Kethiri rahimehull-llah , gjatë tefsirit të këtij ajeti thotë: “All-llahu tebareke ve teala përmend begatitë e Tij që ia ka dhuruar robit; prej këtyre begative është edhe shtëpia që është vend ku banojnë, mbrohen dhe në të cilën kanë shumë dobi”.

Vallë çdo të thotë shtëpia për ne? A nuk është shtëpia vendi ku hamë, pimë, flejmë, pushojmë dhe kemi marrëdhënie bashkëshortore!? A nuk është vendi ku tubohemi me familjen tonë? A nuk është vendi ku mbrohet gruaja?

All-llahu i Plotfuqishëm thotë:

"Dhe rritni në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj..."

(El-Abzab:33)

Nëse shikon gjendjen e njerëzve që nuk kanë shtëpi, të cilët jetojnë rrugëve ose nëpër parqe, ose nëse shikon gjendjen e refugjatëve të cilët jetojnë nëpër kampe të ndryshme, kupton begatinë e shtëpisë. Gjithashtu e kupton rëndësinë e shtëpisë dhe se çfarë çrregullimi buron nga mosposedimi i shtëpisë kur të dëgjosh dikë duke thënë: nuk kam vendqëndrim të caktuar, një ditë flej tek fulani, ditën tjetër në kafeteri, në park ose në bregdet; rrobat gjithmonë i mbaj me vete.

All-llahu xhel-le xhelaluhu hebrenjtë prej fisit Benu Nadir i dënoi duke ua marrë këtë begati dhe duke i nxjerur prej shtëpiave të tyre. E tregon këtë duke thënë:

"Ai është që në dëbimin e parë i nxori prej shtëpive të tyre ata nga ithtarët e librit, të cilët nuk besuan. Ju nuk menduat se ata do të dalin, e ata menduan se fortifikatat e tyre do t'i mbronin prej ndëshkimit të All-llabut, po All-llahu u erdhi atyre nga nuk e kishin menduar dhe në zemrat e tyre hodhi frikën ashtu që me duart e veta dhe me duart e besimtarëve rrëzonin shtëpitë e tyre; pra merrni mësim o ju të zotët e mendjes!"

(Et-Hasbr: 2)

Ç'e stimulon muslimanin për t'i dhënë rëndësi përmirësimit të shtëpisë

Një: Mbrojtja e vetvetes dhe familjes prej zjarrit të xhehennemit.

All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

"O ju që besuat, ruani veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilët janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt të rreptë e të ashpër që nuk kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar".

(Et-Tabrim: 6)

Dy: Përgjegjësia e madhe që ka bariu (përgjegjësi) i shtëpisë para All-llahut subhanehu ve teala Ditën e gjykimit.

Pejgamberi ? thotë:

"All-llahu i Lartësuar do ta pyetw çdo bari (përgjegjës) për tufën që e ka pasur nën përgjegjësinë e tij, a e ka ruajtur apo e ka humbur, derisa të pyetet njeriu për anëtarët e shtëpisë së vet".

Hadithi është hasen, tra. Ibni Hibbani.

Tre: Pasiqë shtëpia është vendi ku mbrojmë veten, jemi të qetë prej të këqiave dhe është vendi ku duhet ndejtur muslimani gjatë kohës së fitnes, atëherë duhet dhënë rëndësi të ndejturit në shtëpi, ngase Muhammedi ? thotë:

"Xbenneti qoftë për atë që e mbisundon gjubën, i mjafton shtëpia e vet dhe për atë që qan mëkatin e vet".

Hadithi është hasen, tra. Taberaniu.

Muhammedi ? thotë:

"Atë që bën njërën prej këtyre pesw veprave, All-llahu i Lartësuar do ta sigurojë: atë që viziton një të sëmurw, atë që del për të luftuar, atë që hyn tek imami (kryetari) për ta ndihmuar dhe madhëruar dhe atë që rri në shtëpi, njerëzit janë rehat prej tij por edhe ai është rehat prej njerëzve".

Tra. Abmedi.

Muhammedi ? thotë:

"Shpëtimi i njeriut gjatë kohës së fitneve (sprovimeve) është të rrijw në shtëpinë e vet".

Hadithi është sabih, tra. Ibn Ebi Asimi në librit e tij Es-sunneh.

Muslimani mund të shohë dobinë e kësaj çështjeje në kohë të vetmisë, në kohë kur nuk do të mund t'i ndryshojë shumë vepra të këqija, në këtë rast shtëpia i bëhet vendbanim në të cilin e mbron veten prej veprës së ndaluar dhe shiqimit të ndaluar, gjithashtu mbron familjen e vet nga lakuriqësia, kurse fëmijët nga shoqëria e keqe.

Katër: Njerëzit pjesën më të madhe të kohës së tyre e kalojnë në shtëpi, sidomos kur është shumë nxehtë ose shumë ftohtë, kur bie shi, pasi të kryejnë punën dhe pas mësimit. Për këtë shkak këtë kohë (që kalojnë në shtëpi) duhet harxhuar në vepra me të cilat është i kënaqur All-llahu, përndryshe do ta harxhojnë këtë kohë në gjëra të ndaluara (haram).

Pesë: Shtëpia është faktor i rëndësishëm për ndërtimin e shoqërisë Islame, ngasa qëliza kryesore e shoqërisë është shtëpia. Çdo shtëpi është një tullë në shoqëri, nëse këto tulla janë të mira, kjo shoqëri do të bëhet aq e fortë saqë do t'u qëndronte ballë armiqtëve të All-llahut, në tw do të përhapej e mira dhe do të ndalohej e keqja.

Kjo shtëpi mund të nxjerë burra që do të përmirësojnë hallin e shoqërisë. Vetëm prej shtëpive të tilla mund të dalin thirrës shembullorw, kërkues të diturisë, muxhahidë të sinqertë, femra të ndershme, nëna edukatore...etj.

Pasiqë kjo temë qenka kaq e rëndësishme,e shtëpitw tona janë përplot gjëra negative, atëherë parashtrohet pyetja:

Cilat janë mjetet për përmirësimin e shtëpive?

Përgjigje e kësaj pyetje janë këto këshilla që do t'i përmend më poshtë. Lusim All-llahun e Lartësuar që këto këshilla t'u bëjnë dobi muslimanëve dhe ta orijentojw mundin e bijve muslimanw kah ringjallja e rolit të shtëpisë në shoqëritë e tyre!

Këto këshilla kanë të bëjnë me dy gjëra:

- a) arritja e dobisë, që personifikohet në të urdhëruarit në të mirë dhe
- b) largimi i dëmeve, që personifikohet në ndalimin nga veprat e këqija.

PËRBËRJA E SHTËPISË **KËSHILLA E PARË:** **TA ZGJEDHËSH MIRË GRUAN**

All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

"Dhe martoni të pamartuarat dhe robërit e robëreshat që janë të ndershëm dhe të ndershme. Nëse janë të varfër, All-llahu i begaton nga mirësitë e Tij, All-llahu është Bujar i madh, i Gjithbvdijshëm".

(En-Nur: 32)

Pronari i shtëpisë duhet të zgjedhë grua të mirë, e cila duhet t'i posedojë disa kushte, të cilat i ka treguar Muhammedi ?:

1- “Gruaja martohet për katër gjëra: për pasurinë e saj, për ate se i takon familjes së ndershme, për bukurinë e saj dhe për fenë e saj. Zgjidhe ate që ka fe, të lumshin duart!” Tra. Buhariu dhe Muslimi

2- “Tërë bota është kënaqësi, kurse kënaqësia më e mirë në këtë botë është gruaja e mirë”. Tra. Muslimi

3- “Secili prej jush le të ketw zemër falënderuese, gjuhë përmendëse (që përmend All-llahun shumë) dhe grua besimtare, e cila e ndihmon në veprat për ahiret”. Hadithi është sahih, tra. Ahmedi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxheja.

4- Në transmetimin tjetër qëndron “dhe grua të mirë, e cila e ndihmon në çështjet e kësaj bote dhe në çështjes e fesë. Kurse kjo është thesari më i mirë që posedojnë njerëzit”. Hadithi është sahih, tra. Bejhakui

5- “Martoni ato të cilat i doni dhe të cilat lindin, ngase unë do të krenohem me numrin tuaj të madh në Ditën e Ringjalljes para pejgamberëve tjerë!” Hadithi është sahih, tra. Ahmedi

6- “Martohuni me beqare, se ato japin më shumë fëmijë, kanë gojë të ëmbël dhe kënaqen më pak”, në transmetimin tjetër qëndron “dhe më pak tradhtojnë”. Hadithi është sahih, tra. Ibni Maxheja

Ashtu siç është gruaja e mirë njëra prej katër kënaqësive të kësaj bote, ashtu është gruaja e keqe njëra prej fatëkeqësive të kësaj bote, siç thotë Pejgamberi ?:

“Prej lumturisë është gruaja e mirë, e cila kur e shiqon të pëlqen, kur mungon prej saj je i sigurtë në te dhe në pasurinë tënde. Kurse nga fatkeqësia është gruaja, e cila kur e shiqon, të dëshpron, flet kundër teje dhe kur mungon prej saj, nuk je i sigurtë në te dhe në pasurinë tënde”.

Hadithi është sabih, tra. Ibni Hibbani.

Përballë kësaj medoemos duhet të dihet gjendja e djalit, i cili i ofron vajzës muslimane martesë, kurse pëlqimi duhet të ndodhë duke patur parasysht këto kushte:

“Nëse ju vjen (për fejesë) ai, me moralin dhe fenë e të cilit jeni të kënaqura, martohuni me të. Nëse nuk e bëni këtë atëherë ndodhë çorodi dhe çrregullim i madh në tokë”.

Hadithi është sabih, tra. Ibn Maxheja.

Për gjithë këtë që e thamë duhet të pyetet mirë dhe të mblidhen informata të sakta, me qëllim që të mos rrënohet shtëpia e cila do të ngrihet me martesën e këtyre dy çifteve.

Burri i mirë dhe gruaja e mirë ndërtojnë shtëpi të mirë, ngase toka e mirë jep fryte të mira, kurse toka e keqe jep fryte shumë rëndë ose nuk jep aspak!

KËSHILLA E DYTË: MUNDOHU TA PËRMIRËSOSH GRUAN

Nëse gruaja është e mirë, atëherë duhet lavdëruar All-llahun për këtë begati, mirëpo nëse ndodhë që gruaja të mos jetë e mirë, atëherë pronari i shtëpisë e ka për detyrë të mundohet që ta përmirësojë. Kjo mund të ndodhw në këto raste:

- a) Burri është martuar me grua jofetare, ngase në kohën e martesës edhe ai nuk ka qenë fetar i madh;
- b) Burri është martuar me një grua jofetare me shpresë se do të përmirësohet, ose
- c) është martuar nga presioni i anëtarëve të shtëpisë.

Në këto raste burri duhet të mundohet që ta përmirësojw gruan e vet. Normalisht nuk duhet harruar se udhëzimi është në Dorë të All-llahut, All-llahu është Ai që Udhëzon. Duke u nisur nga ky fakt, një begati prej begative të All-llahut ndaj Zekerijasë është fjala e All-llahut: “dhe ia përmirësuam bashkëshorten e tij”. (El-Enbija: 90) Ky përmirësim ka të bëjë edhe me trupin edhe me fenë e saj. Ibni Abbasi radijall-llahu anhu thotë: Ishte sterile, nuk lindte, e pastaj lindi. Kurse Atau radijall-llahu anhu thotë: Fliste shumë e All-llahu e përmirësoi.

T'i përmendim disa metoda për përmirësimin e gruas:

- 1) Duhet dhënë rëndësi përmirësimit të ibadetit të saj ndaj All-llahut.
- 2) Duhet munduar që ta ngritësh (rritësh) imanin e saj me këto gjëra:

- a) Nxite në namaz nate
- b) Nxite që të lexojë Kur'an
- c) Mësoja përmendësh disa dhikre që janë të caktuara për disa kohë dhe për disa raste (siç është dhikri i mëngjesit dhe mbrëmjes, dhikru gjatë daljes prej shtëpisë etj.)
- d) Nxite të jepë sadaka
- e) Nxite të lexojë literaturë Islame
- f) Nxite të dëgjojnë kasete të dobishme, ligjerata që i shtojnë njohuritë e saja fetare dhe ligjerata që ia rrisin imanin
- g) Zgjidhi asaj shoqe fetare dhe bëja të mundëshme të ndërldhin marrëdhënie shoqërore dhe të vizitohen mes vete
- h) Largoji të këqijat prej saj dhe mbylli të gjitha dritaret e së keqes, duke e larguar prej shoqeve dhe vendeve të këqija.

Besimi në shtëpi

KËSHILLA E TRETË: BËJE SHTËPINË VEND KU PËRMENDET ZOTI

Muhammedi ﷺ thotë:

"Shembulli i shtëpisë në të cilën përmendet All-llahu dhe shtëpisë, në të cilën nuk përmendet All-llahu, është sikur shembulli i të gjallit dhe të vdekurit".

Tra. Muslimi

Pra, medoemos duhet bërë shtëpinë vend ku përmendet All-llahu, pa marrë parasysh llojin e dhikrit, qoftë dhikër me zemër, me gjuhë, ose falje e namazeve, lexim i Kur'anit, përkujtim i lëndëve të shariatit ose lexim i librave të ndryshëm.

Sot, sipas hadithit të lartëpërmendur, shumë shtëpi të muslimanëve janë të vdekura, ngase nw to nuk përmendet All-llahu. Përkundrazi, në shtëpitë e muslimanëve sot, dwgjohe muzika (zëri i shejtanit), të marrurit nëpër gojë, shpifja, përgojimi etj! Shtëpitë tona janë përplot mëkate, siç është përzierja e burrave me gratë, ecja shpluar para farefisit që nuk është mahrem, ose para fqit etj.

A thua vallë si mund të hyjnë melekët në këto shtëpi!?

Për këtë duhet ngjallur shtëpitw tona duke përmendur All-llahun.

KËSHILLA E KATËRT: **BËJENI SHTËPINË TUAJ VEND ADHURIMI**

All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

“Ne i thamë Musait dhe vëllait të tij t’i bëni vend në Egjipt popullit tuaj, shtëpitë tuaja t’i: bëni faltore (kible) e ta falni namazin rregullisht dhe përgëzoji besimtarët”.

(Junus: 87)

Ibni ‘Abbasi radijall-llahu anhu, gjatw komentit të këtij ajeti, thotë: Janë urdhëruar që shtëpitw e tyre t’i bëjnë xhamia. Kurse Ibni Kethiri thotë: "Siç duket, e Zoti e di më mirë, kur u shtua sprovimi nga Faraoni dhe populli i tij, e u ngushtuan mundësitë, u urdhëruan të falin namaz shumë, siç thotë All-llahu xhel-le shanuhu: *“O ju që keni besuar, kërkoni ndihmë me durim e me namaz”.* (El-Bekare: 153). Kurse në hadith, të cilin e transmeton Ebu Davudi me sened hasen qëndron: "Kur e shqetësonte ndonjë send Pejgamberin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem falte namaz"

Kjo që thamë sqaron rëndësinë e adhurimit në shtëpi, sidomos në kohë kur muslimanët janë të dobët, e nuk mund të falen haptazi para kafirëve.

I tillë ka qenë mihrabi (dhoma) i Merjemes, e cila dhomën e saj e kishte bërë vend adhurimi. All-llahu xhel-le shanuhu, për këtë thotë: *"Sa herë që Zekerija hynte në Mibrabin (dhomën) e saj, gjente tek ajo ushqime..."* (Ali Imran: 37)

As’habët, radijall-llahu anhum, i jepnin rëndësi të madhe faljes së namazit në shtëpi, kuptohet namazeve nafie, sunneteve.

Një gjë të tillë argumenton ky tregim. Transmetohet nga Mahmud ibn Rebi' El-Ensariu radijallahu anhu se I'tban ibn Maliku, i cili ishte as'hab i Pejgamberit ?, ishte Ensari dhe kishte marrë pjesë në betejën e Bedrit, një ditë shkoi te Pejgamberi ? dhe i tha: O Pejgamber i All-llahut! Unë jam imam i popullit tim, mirëpo më është dobësuar shiqimi, ashtu që kur bie shi, lugina që është ndërmjet meje dhe tyre mbushet me ujë, dhe për këtë shkak nuk mund të shkoj në xhaminë e tyre e tua falë namazin. Kam dëshirë, o Resulull-llah që të vish e të falesh në shtëpinë time, që këtë vend ta bëj vendfalje. Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem i tha: "Do ta bëj një gjë të tillë, insha-All-llah. "Thotë I'tbani: Pas dreke erdhi Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem dhe Ebu Bekri. Kërkoj leje Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e unë i dhash leje (për të hyrë në shtëpi). Pasiqë hyri në shtëpi nuk u ul, por tha: "Në cilin vend të shtëpisë sate dëshiron të falem?" Tha (I'tbani): drejtova gishtin në një drejtim të shtëpisë. U drejtua kah kibra, mori tekbir dhe filloi të falet, kurse ne rënditëm saffat dhe u falëm pas tij. I fali dy rekate, pastaj dha selam".Transmeton Buhariu.

Ibni Haxheri duke përmendur dobitë e këtij hadithi thotë: "Në këtë hadith ka argument për caktimin e një vendi në shtëpi për t'u falur. Kurse sa i përket ndalimit të caktimit vend në xhami, sipas hadithit që e transmeton Ebu Davudi ka të bëjë nëse kjo vepër bëhet me syfaqësi. Gjithashtu nga ky hadith mwsohet se përcaktimi i një vendi për t'u falur nuk konsiderohet vakëf, as që i mvishen rregullat e vakëfit, edhe pse quhet mesxhid".

KËSHILLA E PESTË: EDUKIMI FETAR NË FAMILJE

Transmetohet nga Aisheja radijall-llahu anha, e cila thotë: "Pejgamberi ? falte namaz nate, kurse kur fillonte të falë namazin e vitrit thoshte: "Oj Aishe, ngrehu dhe fale vitrin". Tra. Muslimi

Muhammedi ? thotë:

"E mëshiroftë All-llahu njeriun, i cili ngribet për të falur namaz nate dhe e zgjon edhe gruan e tij për të falur, e nëse ajo refuzon, e stërpikë fytyrën e saj me ujë".

Hadithi është sahih, tra. Ahmedi dhe Ebu Davudi.

Duhet nxitur gratë në shtëpi që të japin sadaka, ngase kjo vepër e rritë imanin, gjithashtu është vepër në të cilën Pejgamberi ? ka nxitur, duke thënë:

"Gra! Jepni sadaka, ngase ju kam parë se jeni pjesa më e madhe e banorëve të xhebennemit".

Tra. Buhariu.

Prej ideve të mira në këtë kontekst është vendimi i një kutie, në të cilin çdo antar i familjes do të vendonte vullnetarisht të holla, të cilat pastaj do t'u shpërndahen të varfërve dhe atyre që kanë nevojë. Gjithë kjo shumë e cila tubohet në këtë sanduk do të jetë pronë e atyreve që kanë nevojë.

Nëse gjindet në shtëpi kush agjëron ditët e bardha (dita e trembëdhjetë, katërmbëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë e çdo muajit hixhrit), të hënën dhe të ejtën, ditën e nëntë dhe të dhjetë të muajit Muharrem (Tasuan dhe Ashuranë), ditën e Arafatit, kjo do të jetë nxitës që antarët tjerë të familjes ta kenë shembull këtë individ në jetën e tyre.

KËSHILLA E GJASHTË: DHËNIA RËNDËSI DHIKREVE DHE SUNNETEVE QË KANË TË BËJNË ME SHTËPINË.

Për shembull:

Përmendja e All-llahut gjatë hyrjes në shtëpi

Transmeton Imam Muslimi në Sahihun e Tij se Pejgamberi ? thotë:

"Kur të hyjë njeriu në shtëpi dhe ta përmendë emrin e All-llahut gjatë hyrjes dhe gjatë ngrënies, shejtani thotë: s'keni as vend për të fletë e as darkë për të ngrënë, kurse nëse hyn dhe nuk e përmendë emrin e All-llahut, shejtani thotë: gjetët vend për të fletur, e nëse nuk e përmendë emrin e All-llahut gjatë ngrënjes, shejtani thotë: gjetët vend për të fletur dhe për të ngrënë darkë".

Tra. Imam Ahmedi dhe Muslimi

Përmendja e All-llahut gjatë daljes prej shtëpisë

Transmeton Ebu Davudi në Sunenin e tij se Pejgamberi ? thotë:

"Kur të del njeriu prej shtëpisë dhe të thotë: "Bismil-lah, tevekelto a'lall-llah, ve la havle ve la kuvvete il-la bil-lah (Me emër të All-llahut, në All-llahun mbështetem, askush s'ka mundësi dhe forcë përveç All-llahut), i thubet: të mjafton; u udhëzove, të mjafton kjo nga vështirësitë dhe u mbrojte, dhe largohet në këtë rast shejtani nga ky, kurse shejtani tjetër i thotë: ç'mund t'i bësh njeriut që është udhëzuar, nuk ka vështirësi dhe është i mbrojtur".

Hadithi është sahih.

Misvaku

Transmeton Imam Muslimi në Sahihun e tij nga Aisheja radijall-llahu anha, e cila thotë:

"Pejgamberi ? kur hynte në shtëpi gjëja e parë që bënte ishte përdorimi i misvakut"

KËSHILLA E SHTATË: **LEXIMI I PANDËRPERË I SURES BEKARE NË SHTËPI** **ME QËLLIM QË TË LARGOHET SHEJTANI**

Për këtë temë ka disa hadithe:

Resulull-llahu a.s thotë:

"Mos i bëni shtëpiat e juaja varre, ngase shejtani ikë nga shtëpia në të cilën lexohet sureja Bekare".

Tra. Muslimi

Muhammedi a.s. thotë:

"Lexoni suren Bekare në shtëpitë tuaja, ngase shejtani nuk hyn në atë shtëpi që lexohet sureja Bekare".

Hadithi është sahib, tra. Hakimi

Muhammedi a.s. duke treguar vlerën e dy ajeteve të fundit të sures Bekare dhe ndikimin e tyre në shtëpi thotë:

"All-llahu i Lartësuar ka shkruar Librin 2000 vjet para se t'i krijojë qiejt dhe tokën, kurse Ai ka qenë në Arsh (fron) dhe i zbriti dy ajete me të cilat përfundoi suren Bekare. Në atë shtëpi që lexohen këta dy ajete tre ditë, shejtani nuk i afrohet asaj shtëpie".

Hadithi është sabih, tra. Tirmidhiu, Nesaiu dhe Hakimi.

SHKENCAT E SHERIATIT NË SHTËPI

KËSHILLA E TETË:

MËSIMI I ANËTARËVE TË SHTËPISË

Kjo vepër është farz për të pronarin e shtëpisë dhe ai duhet realizuar këtë farz në shenjë dëgjueshmërie ndaj All-llahut, i cili thotë:

"O ju që besuat, ruani veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët..."
(Et-Tabrim: 6)

Në këtë ajet bazohet domosdoshmëria e të mësuarit dhe edukimit të anëtarëve të familjes, duke i urdhëruar në të mirë dhe duke i ndaluar nga e keqja.

Dëshiroj t'u paraqes disa thënie të mufesirëve rreth këtij ajeti, që t'u bëhet më e qartë detyra e pronarit të shtëpisë:

Katadeja rahimehull-llah thotë: "I urdhëron të respektojnë All-llahun, i ndalon nga të bërit mëkat. Ai vet t'i veprojë urdhërat e All-llahut dhe t'i urdhërojë anëtarët e familjes në këto urdhëra dhe t'u

ndihmojë në realizimin e këtyre urdhërave, kurse nëse tek ata sheh ndonjë mëkat, atëherë duhet t'i largojë nga ky mëkat dhe t'i kritikojë për këtë gjë".

Dahaku dhe Mukatili thonë: "Muslimani e ka për detyrë që t'ua mësojë familjes së vet, farefisit dhe shërbëtorëve, veprat që ua ka bërë obligim All-llahu dhe veprat që ua ka ndaluar".

Aliu radijall-llahu anhu thotë: "Mësoni dhe edukoni (anëtarët e familjes)". Kurse Taberiu rahimehull-llah thotë: "Detyrë e kemi t'ua mësojmë fëmijëve dhe grave tona fenë, veprat e mira dhe moralin e lartë".

Nëse Pejgamberi ? ka urdhëruar që t'i mësojmë robëreshat, atëherë edhe më parë do të ishte obligim t'i mësojmë gratë dhe fëmijët tonë.

Imam Buhariu në Sahihun e tij një kaptinë të tërë ka titulluar: "Kaptina: Mësimi i burrit gratë dhe robëreshat e tij", pastaj ka përmendur hadithin e Pejgamberit ?, ku thotë: "Tre lloj njerëzish kanë nga dy shpërblime: ...dhe njeriu i cili ka poseduar robëreshë dhe të cilën e ka edukuar mirë dhe e ka mësuar mirë, e pastaj e ka liruar dhe e ka martuar. Ky person ka dy shpërblime".

Ibni Haxheri rahimehull-llah duke komentuar këtë hadith thotë: "Titulli i kaptinës përputhet me hadithin që ka përmendur më poshtë sa i përket robëreshës me teks, kurse sa i përket gruas me analogji, pasi që mësimi i farzeve të All-llahut dhe sunneteve të Pejgamberit ? familjes që janë të lirë është më e rëndësishme se mësimi i këtyre çeshtjeve robëreshës".

Njeriu duke pasë parasysh se është shumë i zënë me punën e tij ose me detyrat që i ka, mund të harojë ta caktojë një kohë, në të cilën do t'ia mësonte familjes së vet çeshtjet e fesë. Mirëpo rrugëdalje për këtë është caktimi i një dite për takim të përgjithshëm me antarët e familjes, bile

edhe për farefisninë më të gjerë, me qëllim mësimi. Të gjithë i informon për këtë takim, kurse prezentimi le të bëhet i domosdoshëm për atë që ka dëshirë të jetë i pranishëm, kështu do të praktikonim atë që ka vepruar Pejgamberi ?.

Imam Buhari rahimehull-llah në Sahihun e tij thotë: "Kaptina: A t'u caktohet grave një ditë për mësim?" pastaj përmend Hadithin që transmeton Ebu Seid El-Hudriu radijall-llahu anhu, i cili thotë: Një ditë disa gra Pejgamberit ? i thanë: Burrat na fituan, na cakto një ditë (për mësim). Pejgamberi ? iu premtoi një ditë, në të cilën u takua me to. Në këtë ditë i këshilloi dhe i urdhëroi (në vepra të mira)".

Ibni Haxheri rahimehull-llah thotë: "Në transmetimin e Sehl Ibn Ebi Salihut, i cili transmeton nga babai i tij, e ky nga Ebu Hurejreja radijall-llahu, qëndron: "Pejgamberi ? u tha: "Takimi ynë është te shtëpia e filanes. Ata erdhën te kjo shtëpi, e Pejgamberi ? u mbajti fjalim".

Nga ky hadith mund të kuptojmë: lejohet mësimi i grave në shtëpi, kujdesin e as'habëve për të fituar dituri dhe se forcat e davetçit nuk duhen të orijentohen vetëm kah burrat, por duhet përfshirë edhe gratë me programin e tij.

Ndoshta ndonjë lexues thotë: Ja. Caktuam një ditë për të mësuar dhe informuam familjen, mirëpo si të fillojmë? Çka tu ofrojmë në këto tubime?

Si përgjigje i propozoj një planprogram të thjeshtë në të cilin mund të mbështetet gjat marrjes së mësimëve në këto tubime:

1-Në lëndën e tefsirit: Tefsiri i Ibni Sa'dit, i quajtur "Tejsirul-Kerimir-Rahman fi tefsiri Kelamil-Mennan", është 7 vëllime dhe është i lehtë. Nga ky tefsir lexon ndonjë sure dhe komentin e saj ose ndonjë ajet dhe komentin e tij.

2-Në lëndën e hadithit: "Rijadus-salihin"- libër që përmbledhë hadithe. Çdo tubim lexon disa hadithe me një koment të shkurtër. Për këtë mund të mbështetesh gjithashtu në librin "Nuz'hetul-Muttekin", i cili përmbledh komentin e këtij libri.

3-"Husnul-Usveti bima thebet anil-lahi ve anir-resulihî fin-nisveh", i dijetarit Siddik Hasen Han. Gjithashtu me rëndësi është që t'i mësohet gruas disa vendime të fikhut, siç janë rregullat e pastërtisë, rregullat e menstruacionit, rregullat e namazit, zekatit, agjërimit dhe haxhxit (nëse ka mundësi të shkojë në haxh). Duhet mësuar asaj rregullat e ngrënies, pirjes, veshmbathjes dhe zbukurimit. Duhet mësuar asaj dhjetë rregullat e fitres (natyrshmërisë), vendimin e sheriatit mbi muzikën, fotografitë etj. Normalisht duhet dhënë rëndësi që të mirren këto rregulla nga burimet e sakta, siç janë fetvatë e dijetarëve që mbështeten në argumente.

Në këtë hyn edhe përkujtimi i antarëve të familjes mbi kohët e ligjeratave që i ligjerojnë dijetarët dhe kërkuesit e diturisë nëpër xhamia dhe përkujtimi i antarëve të familjes për ditët e caktuara për vizitimin e panairove të librit nga ana e grave, normalisht duke pasë parasysh kushtet e sheriatit.

KËSHILLA E NËNTË: BËN BIBLIOTEKË ISLAME NË SHTËPINË TËNDE.

Prej çështjeve që i ndihmojnë antarëve të familjes në mësimin e tyre dhe që i ofron rast për ta kuptuar fenë mirë dhe për të vepruar sipas rregullave të shariatit është bërja e një biblioteke islame në shtëpi. S'është patjetër të është e madhe, mirëpo me rëndësi është zgjedhja e mirë e librave dhe vëndosja e tyre në vënd të përshtatshëm, në vënd që i nxit antarët e familjes për t'i lexuar këta libra.

Kjo bibliotekë mund të vendoset në dhomën e ndejës, në dhomën e fletjes, në dhomën e mysafirëve, me rëndësi është të jetë në vend praktik për antarët e familjes.

Nga përsosmëria e bibliotekës (e All-llahu don përsosmërinë) është që biblioteka të përmbajë libra, të cilat vlejnë për të studiuar lëmi të ndryshme, libra të cilat edhe do tu bëjnë dobi fëmijëve në shkollë por edhe antarëve tjerë të familjes. Kjo bibliotekë duhet të posedojë libra edhe për të mëdhenj edhe për të vegjël. Gjithashtu është mirë që kjo bibliotekë të posedojë libra, të cilat u jipen dhuratë musafirëve, shokëve, fëmijëve, vizituesve të familjes etj. Pastaj duhet dhënë rëndësi që botimi të jetë tërheqës, të jenë të përpunuar dhe cenzuruar në aspektin e hadithit.

Për të formuar bibliotekë shtëpie mund të përfitosh nga panairët e librit, normalisht pasiqë të konsultohesh me ata që marrin vesh këtë lëmi.

Duhet rregulluar librat sipas tematikës me qëllim që të lehtësohet gjetja e librit të duhur në kohë të caktuar. Pastaj mirë është që njëri prej antarëve të familjes të bëjë bibliografinë e librave sipas abecedës dhe bibliografi kronologjike, më qëllim që ta lehtësojnë gjetjen e librit të nevojshëm.

Normalisht pas kësaj që thash shumica prej jush do të pyesin për emrat e librave islame që duhet poseduar?

Si përgjigje po i propozoj këta libra:

Tefsir: "*Tefsiri i Ibni Kethirit*",...etj.

Hadith: "*Fjala e bukur*", "*Rijadus-Salibin*" me komentin e tij "*Enciklopedia e dijenisë dhe urtësisë¹*", "*Sahihul-Buhari*",...etj.

Akide: "*Besimi, bazat esenca dhe negacioni²*".

Fikh: "*Zadul-Meadî*" i Ibn Kajjim El-Xhevziut,...etj.

Ahlak: "*Morali i besimtarit³*",... etj.

¹ Liber që është në gj. shqipe dhe i propozuar nga red.

² Liber që është në gj. shqipe dhe i propozuar nga red.

³ Liber që është në gj. shqipe dhe i propozuar nga red.

Histori dhe biografi: "*Nektari i vulosur i xhenetit*"⁴ i Mubarekfurit,...etj

Ekzistojnë edhe disa libra të mirë të autorëve bashkëkohor, siç janë librat e Sejid Kutbit, "Islami fe e ardhmërisë", "Kjo fe", "Shenjat në rrugë" etj, librat e Muhammed Kutbit, siç janë "Minhexhut-Terbijetil-Islamije" (Metodologjia e edukatës islame) dy vëllime, librat e shejh Jusuf Kardavit siç janë: "Hallali dhe harami ne islam", "Rizgjimi islam ndërmjet kundërshtimit dhe ekstremizmit", etj. Librat e Ebul-A'la El-Mevdudit, librat e ebul-Hasen En-Nedevit, librat e dr. Omer Eshkarit, librat e Selman Audes, librat e Aid el-Karnit, Nasir El-Omerit, etj.

Këto tituj që u përmendën janë vetëm shembuj, ngase ka shumë libra dhe broshura që janë të dobishme e që ne nuk i kemi përmendur këtu ngase nuk kemi hapësirë dhe nuk është vendi këtu. Mirëpo mbetet detyrë e muslimanit që të pyetë dhe të konsultohet me dijetarë dhe kërkues të diturisë me përvojë për librat që ka dëshirë t'i blejë dhe me to të mbush bibliotekën e tij shtëpiake.

⁴ Liber qe është në gj. shqipe dhe i propozuar nga red.

KËSHILLA E DHJETË: BË NË SHTËPI NJË BIBLIOTEKË AUDIO KASETASH

Kasetofoni mund të përdoret për të mirë ose për të keqe. Mirëpo muslimani duhet të mendojë se si mund ta shfrytëzojë këtë mjet në gjëra në të cilat është i kënaqur All-llahu?

Për ta realizuar këtë qëllim duhet bërë një biblioteke audio kasetash, bibliotekë e cila do të përmbajë disa kaseta me lexime të Kur'anit, disa ligjerata të dijetarëve, hoxhallarëve dhe hatibave, sepse dëgjimi i kasetave, në të cilat është inçizuar ndonjë lexim i ndikueshëm prej imamëve që lexojnë gjat namazeve ka ndikim pozitiv tek antarët e familjes; do të ndikojë nëpërmjet domethënieve të ajeteve të lexuara, do t'u mundësojë që më lehtë të mbajnë mend ato ajete që i dëgjojnë, nga shkak që përsëriten shumë ose do ta zëvendësojë dëgjimin e muzikës me dëgjim të Kur'anit, duke mos lejuar që në veshët dhe gjoksin e tyre të përzihen Fjala e Rahmanit dhe fyejt e shejtanit.

Kasetat në të cilat gjenden fetva të hoxhallarëve eminent ndikojnë në ngritjen e vetëdijes fetare tek anëtarët e familjes, nga këto kaseta mësojnë shumë rregulla dhe vendime të shariatit, për të cilat kanë nevojë çdo ditë. Propozojmë që prej kasetave të cilat duhet dëgjuar të jenë kasetat e Hoxhe Jakup Hasipit, Dr. Zekerija Bajramit, Dr. Shefqet Krasniqit, , Sadullah Bajramit, Husamedin Abazit etj⁵.

⁵ Hoxhollarë tanë të propozuar nga red. në vend të atyre që propozoi aut.

Muslimani medoemos duhet t'i jepë rëndësi anës nga e cila merr fetvanë, ngase kjo fetva është fe dhe për këtë duhet shiquar nga e marrim këtë fe. Fetvaja miret nga ai që është i mirë, i devotshëm, bazohet në hadithe sahihe, nuk është ekstrem, por pason argumentin, është mesatar, as nuk është shumë rigoroz e as shumë tolerant, ky është i dijsلمي të cilin duhet pyetur, siç thotë All-llahu xhel-le shanuhu:

"Ai është Mëshiruesi. Për këtë pyet ndonjë shumë të dijsëm".

(El-Furkan: 59)

Pastaj është e nevojshme që të dëgjoen kasetat e atyre që mundohen ta zgjojnë këtë ummet nga gjumi, që mundohen të urdhërojnë në të mirë dhe të ndalojnë nga e keqja, ngase kjo ka rëndësi të madhe në ndërtimin e personalitetit të një individi në familjen muslimane.

Kaseta të këtij lloji ka shumë dhe janë të përhapura me të madhe ashtu që s'ka nevojë të përmenden.

Gjithashtu kemi vërejtur se kasetat për fëmijë kanë ndikim të madh tek fëmijët tanë; atyre u mësojnë disa sure të vogla të Kur'anit, u mësojnë dhikret e mëngjesit dhe mbrëmjes, u mësojnë disa rregulla Islame, u mësojnë disa kaside të dobishme etj.

Kasetave duhet bërë rafte të mira dhe duhet vënduar në vend ku do të jetë lehtë të përdoren, kurse në të njejtën kohë nuk do të jenë pranë fëmijëve.

Kasetat e mira duhet të përhapen me të madhe duke i dhuruar njerëzve ose duke ua dhënë vetëm për t'i dëgjuar.

Pasiqë gruaja shumicën e kohës e kalon në kuzhinë, është mirë që kasetofoni të gjindet në kuzhinë, me qëllim që ajo ta shfrytëzojë kohën e vet maksimalisht për përfitimin e diturisë.

KËSHILLA E NJËMBËDHJETË: FTUARJA E NJERËZVE TË MIRË DHE DIJETARËVE PËR T'JU VIZITUAR NË SHTËPI

"Zoti im, më fal mua dhe prindërit e mi, dhe ata që hyjnë në shtëpinë time duke qenë besimtarë, edhe besimtarët e besimtarët, ndërsa mizorëve mos u shtoj tjetër pos shkatërrim".

(Nub: 28)

Hyrja e besimtarëve të mirë në shtëpi ia shton dritën (nurin) shtëpisë, kurse biseda dhe dialogu me to i mëson antarët e familjes shumë gjëra, se bartësi i parfumit ose të jep parfum që të parfumosesh, ose blen prej tij ose së paku nuhat erë të mirë nga ai. Dëgjimi i kësaj bisede nga fëmijët, vëllezërit, prindërit, gratë (pas perdes) u bën dobi dhe mësojnë. Pastaj hyrja e të mirit në shtëpinë tënde nuk lë vend për të hyrë i keqi.

KËSHILLA E DYMBËDHJETË: MËSOI VENDIMET E FESË QË KANË TË BËJNË ME SHTËPINË

1-Falja e namazit në shtëpi:

Pejgamberi ? sa i përket burrit thotë:

"Namazi më i mirë i një personi është namazi që e fal në shtëpi, përveç farzët".

Hadithi është sabih, tra. Ebu Davudi.

E sa u përket farzeve, ato duhet falur në xhami, përveç nëse ka ndonjë arsye.

Pejgamberi ? thotë:

"Namazi vullnetar (që falet) në shtëpi është më i vlefshëm se namazi vullnetar (që falet) para njerëzve, ashtu siç është vlera e namazit me xhemat në kerahasim me namazin në vete".

Hadithi është sabih, tra. Ibn Ebu Sbejbe

Kurse sa i përket gruas, më mirë për te është që të falet në vende sa më të fshehura, ngase Pejgamberi ? thotë:

"Namazi më i mirë i gruas është në brendësi të shtëpisë së saj".

Hadithi është sabih, tra. Taberaniu.

2-Mos të bëhet dikush tjetër imam në shtëpinë e pronarit të shtëpisë dhe të mos ulet në vendin e tij përveç se me lejen e tij

Pejgamberi ? thotë:

"Nuk bëhet imam dikush tjetër në pronën e tij, as që ulet dikush në vendin e pronarit të shtëpisë përveç se me lejen e tij".

Hadithi është Sahih, tra. Tirmidhiu.

Dmth. askujt nuk i jipet përparësi para pronarit të shtëpisë edhe pse musafiri mund të jetë më i ditur se pronari i shtëpisë, ashtu si nuk i jipet përparësi dikujt ne xhami para imamit të xhamisë. Gjithashtu nuk lejohet që dikush të ulet në vendin e posaçëm për të pronarin e shtëpisë.

3-Kërkimi i lejës

All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

"O ju që besuat, mos hyni në shtëpi të huaja pa kërkuar leje dhe pa i përshëndetur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju në mënyrë që të merrni mësim. Por nëse nuk gjeni aty asnjë, atëherë mos hyni në to derisa t'ju jepet leje, e nëse ju thubet kethebuni, ju pra kethebuni. Kjo është më e ndershme për ju. All-llahu di çdo gjë që veproni ju".

(En-Nur: 27-28)

"Në shtëpi hyni kah dyert e tyre".

(El-Bekare: 189)

4-Lejohet hyrja në ato shtëpi që nuk banon askush,duke mos kërkuar leje, nëse aty brenda ka diç të veten, siç është shtëpia (dhoma) e caktuar për musafirë.

All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

"Nuk është për ju ndonjë mëkat, nëse hyni në shtëpi të pabanuara, në të cilat keni ndonjë përfitim. All-llahu e di atë që e shfaqni haptas dhe atë që e mbani fshehtë".

(En-Nur: 29)

5-Nuk është mëkat të hash në shtëpinë e shokut ose farefisit dhe në atë shtëpi, çelësin e të cilave e posedon, nëse pronarët e shtëpisë nuk e urrejnë një gjë të tillë.

All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

"Nuk është mëkat për të verbërin, për të çalin, për të sëmurin, as për ju vetë, të hani nga shtëpitë tuaja ose nga shtëpitë e etërve tuaj, shtëpitë e nënave tuaja, shtëpitë e xhaxhallarëve, të hallave, të dajëve tuaj, shtëpitë e tezeve tuaja ose të atyre që jua kanë besuar çelësat e tyre, ose (në shtëpitë) e miqve tuaj. Mund të hani bashkarisht ose veçmas, nuk është mëkat".

(En-Nur: 61)

6-Duhet të urdhërohen fëmijët dhe shërbëtorët që mos të hapin dhomën e fletjes së prindërve pa leje në kohën e gjumit.

Dmth. para namazit të sabahut, pas namazit të drekës (ky pushim quhet kajlule) dhe pas namazit të jacisë, me qëllim që mos të shohin gjëra që nuk duhet parë. Nëse sheh ndonjë send pa dëshirë në kohët tjera, i falet ngase ata janë prej anëtarëve të shtëpisë, rëndë është t'i ndalosh të qarkullojnë.

All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

"O ju të cilët besuat, ata të cilët i keni në pronësinë tuaj (shërbëtorët) dhe ata që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë, duhet të kërkojnë leje prej jush (për të hyrë tek ju) në tri kohë: para namazit të sabahut, në kohë të

drekës kur i hiqni rrobat tuaja (për të pushuar) dhe pas namazit të jacisë, që të tri këto kohë janë kur ju nuk jeni të veshur. Pos atyre tri kohëve nuk është mëkat as për ju as për ata, të vizitoni njeri tjetrin, ngase ata janë në shërbimin tuaj. Kështu All-llahu ua sqaron argumentet e veta. All-llahu është i Dijshëm, i Urtë".

(En-Nur: 58)

7-Ndalohet shiqimi në shtëpitë e huaja pa leje.

Muhammedi a.s. thotë:

"Kush shiqon në shtëpi të huaj pa leje dhe ja nxjerin syrin, për këtë vepër nuk ka as gjakpajim as dënim".

Hadithi është sabih. tra. Ahmedi.

8-Ndalohet dalja ose nxjerja e gruas me divorc kthyes nga shtëpia derisa t'i kalon iddeti

All-llahu xhel-le xhelaluhu thotë:

"O ti pejgamber, kur t'i lëshoni (shkurorezo)ni gratë, lëshoni ato në vigjilje të fillimit të pritjes së tyre (në kohën e pastërtisë së tyre) dhe kohën e pritjes mbani mend mirë e keni frikë All-llabut, Zotit tuaj dhe mos i nxirni ato prej shtëpive të tyre e edhe ato të mos dalin pos nëse bëjnë ndonjë vepër të keqe të vërtetuar (amoralitet). Këto janë kufijtë e All-llabut, e kush del jashta kufijve të All-llabut, ai e ka dëmtuar vetveten. Ti nuk e di, All-llahu pas asaj mund të të jep diçka rishtazi".

(Et-Talak: 1)

9-I lejohet burrit të largohet prej gruas së tij, nëse ajo nuk e respekton, duke u larguar nga krevati ose duke dalur prej shtëpie.

Sa i përket largimit prej saj duke mbetur në shtëpi, argument është ajeti Kur'anor:

"...madje largoni nga shtrati".

(En-Nisa: 34)

Kurse sa i takon largimit nga shtëpia, argument për këtë është vepra e Pejgamberit, i cili u largua prej grave të veta, doli jashta shtëpisë së tyre, saqë edhe hante edhe pinte jashta shtëpie. Tra. Buhariu

10-Mos fle vetëm në shtëpi.

Transmetohet nga Ibni Omeri radijall-llahu anhumu, i cili thotë se "Pejgamberi ? ka ndaluar vetminë, të flejë njeriu vetë ose të udhëtojë vetë".

Hadithi është sabih, tra. Ahmedi

Pejgamberi ? ka ndaluar vetminë, ngase në vetmi njeriu ndihet i vetmuar, i dëshpruar dhe i zymtë. Kur njeriu është vetë lehtë mund ta sulmojë armiku ose ndonjë vjedhës, ose mund të sëmuret, e shoqërimi i shokut me te mund t'i ndihmojë që të mbrohet nga armiku, vjedhësi ose t'i ndihmojë në rast sëmundjeje.

11-Nuk lejohet të flesh në tavan të shtëpisë, i cili nuk ka mur përrethi, me qëllim që të mos biesh.

Pejgamberi ? thotë:

"Për atë që flet në tavan të shtëpisë që nuk ka mure, askush nuk përgjigjet".

Hadithi është sabih, tra. Ebu Davudi

Ka ndaluar Pejgamberi ? këtë vepër ngase njeriu duke fjetur mund të rrotullohet, e nëse është në tavan që s'ka mure, të cilat e pengojnë nga rënia, mund të bieje poshtë dhe të vdesë. E në këtë rast askush nuk përgjigjet për te ose me këtë vepër ka dalë nga mbrojtja e All-llahut, ngase nuk i ka marë parasysh arsyet (shkaqet që të mbrojnë nga kjo rënie).

12-Macja e shtëpisë nuk i fëlliqë enët ose ushqimin nëse han prej tyre.

Transmetohet nga Abdull-llah ibn Ebi Katadeja radijall-llahu anhu, i cili kishte vënduar pjatën me ujë që të merr abdest babai i tij, mirëpo në ndëkohë nga kjo pjatë piu ujë macja, e ai mori abdest nga ky ujë. Disa i thanë: O Ebu Katade, në këtë ujë piu macja. Ebu Katadeja tha: Kam dëgjuar Pejgamberin ? duke thënë:

"Macat janë prej antarëve të familjes dhe janë prej atyre që qarkullojnë shpesh tek ju", në transmetimin tjetër qëndron: "ajo nuk është e papastër, ajo është prej atyre që qarkullojnë shpesh në mesin tuaj".

Hadithi është sabih, tra. Ahmedi.

JETA FAMILIJARE

KËSHILLA E TREMBËDHJETË:

DUHET MBAJTUR TUBIME KU DO TË DISKUTOHEN ÇESHTJET FAMILJARE.

All-llahu xhel-e xhelaluhu thotë:

"ata konsultohen mes vete për punët e përbashkëta të tyre".

(Esb-Shura: 38)

Nëse të gjithë anëtarët e një familjeje tubohen për të diskutuar çështjet familjare, qofshin të brendshme ose të jashtme, dmth se kjo familje është e ndërlidhur dhe mirëkuptohen ndërmjet veti.

Ska dyshim se burri, të cilin All-llahu subhanehu ve teala e ka bërë përgjegjës për familjen, është përgjegjësi i parë dhe vendimtar për çështjet familjare, mirëpo për t'i edukuar fëmijët, sidomos kur të rriten, si duhet baretur përgjegjësinë dhe se konsultimi është elementi kryesor për stabilitetin e familjes, duhet tu jipet rast edhe atyre që të shprehin mendimet e tyre rreth problemeve familjare, bile me këtë i nxitë që të mendojnë rreth zgjedhjes së problemit, pasi që me këtë u tregon se idetë e tyre paskan vlerë.

Për shembull mund të diskutohet shkuarja në Haxhaxh ose shkuarja në Umre gjat Ramazanit ose në pushimet tjera, udhëtimi për të vizituar farefisën ose për dëfrime të lejuara, mund të bisedohet për organizim të dasmës, ose prerja e kurbanit për fëmijën e posalindur, ose për pjesëmarrje në akcione bëmirëse, siç është numrimi i të varfërve në lagje, ofrimi i ndihmave të nevojshmeve etj. Gjithashtu mund të diskutohen çështjet e familjes dhe problemet e farefisit dhe gjetja e zgjidhjeve për problemet e ndodhura.

E shoh të arsyeshme të aludoj edhe në një lloj tjetër të rëndësishëm të tubimeve, siç është biseda e haptë mes prindërve dhe fëmijëve, ngase disa probleme që u ndodhin fëmijëve të moshërritur, nuk mund të zgjidhen mirë përveç se me tubime të veçanta, ku psh. ulet prindi me djalin dhe bisedojnë rreth problemeve me të cilat ballafaqohet çdo i ri, rregullat e pubertetit, sjelljes, etj,

gjithashtu nga ana tjetër ulet nëna me vajzën për t'ia mësuar rregullat e nevojshme të sheriatit dhe i ndihmon për t'i zgjedhur problemet me të cilat ballafaqohet vajza në këtë kohë.

Babai dhe nëna mund të përdorin shprehjet "kur kam qenë në vitet tua...", ngase kjo ndikon shumë në pranimin e këshillës. Përndryshe mosbisedimi i haptë mes prindërve dhe fëmijëve do të shkaktojë që ata këto biseda t'i bëjnë me ndonjë shok të keq ose shoqe të keqe, gjë që mund të shkaktojë devijim tek ata.

KËSHILLA E KATËRMBËDHJETË: NUK DUHET TË SHFAQEN MOSPAJTIMET FAMILJARE PARA FËMIJËVE.

Shumë të rralla janë rastet ku mund të jetojë një bashkësi pa mospajtime dhe pa përçarje, edhe pse pajtimi është më mirë, e kthyerja në të vërtetë është vyrtyt i lavdëruar.

Ajo që dridh mirëkuptimin e familjes dhe dëmton brendësinë e shtëpisë është shfaqja e këtyre problemeve para fëmijëve, kështu që antarët e familjes ndahen në dy pale ose edhe më shumë. Kjo gjë ndikon negativisht në mentalitetin e fëmijëve, sidomos fëmijëve të vegjël. Paramendo një shtëpi në të cilën prindi i thotë fëmijës: mos i flit nënës sate, kurse nëna i thotë: mos i flit babait tënd, pa dyshim kjo shkakton mëdyshje psikike tek fëmijët. Së fundi të gjithë do të jetojnë në dëshprim dhe jetë të zymtë.

Pra, të mos biem në përçarje, e nëse ndodh, atëherë të mundohemi që mos ta shfaqim këtë para fëmijëve tanë. All-llahun e lus që t'i bashkojë zemrat!

KËSHILLA E PESËMBËDHJETË: MOS FUT NË SHTËPI PERSON JOFETAR (AMORAL).

Pejgamberi ? thotë:

"Shembulli i shokut të keq është sikur shembulli i farkëtarit".

Tra. Ebu Davudi, kurse në transmetimin e Buhariut qëndron:

"Gjyryku i farkëtarit ose të djeg shtëpinë, ose t'i djeg rrobat, ose së paku nuhat erë të keqe".

Po, vall-llahi, të djeg shtëpinë me lloj-lloj çorodish. Shumë herë hyrja e këtij lloji njerëzish ka qenë shkak për armiqësi ndërmjet antarëve të familjes, ka ndarë burrin prej gruas, kurse All-llahu ka mallkuar ate që ndan burrin prej gruas ose ndan gruan prej burrit, ose shkakton armiqësi ndërmjet prindit dhe bijve të vet. Për këtë shkak në të shumtën e rasteve shkak për bërjen e sihrit ose ndodhja e ndonjë vjedhjeje ose prishja e moralit të familjes është hyrja e njerëzve jofetar (amoral) në shtëpi. Mu për këtë edhe nuk duhet lejuar që në shtëpitë tona të hyjnë njerëz të tillë madje edhe nëse i kemi fqinjë. Disa njerëz nuk kanë guxim të mos I pranojnë në shtëpitë e tyre njerëzit amoral dhe për këtë kur I sheh në derë e len të hyjë dhe nuk e kthen. Kjo është vrytë negativ,

ngase muslimani duhet të ketë qëndrim të prerë ndaj njeriut të keq. Gjë e cila mund të ndikon pozitivisht në edukimin e këtij njeriu.

Gruaja gjithashtu bart një pjesë të madhe të përgjegjësisë së shtëpisë. Pejgamberi ? thotë:

"O ju njerëz! Ç'farë dite është kjo? Ç'farë dite është kjo? Ç'farë dite është kjo? I thanë: Ditë e Haxhxit të madh. Pastaj Pejgamberi ? ndërmyet tjerash në këtë hutbe të tij përmbledhëse tha: "Detyra e gruas ndaj burrit është që: mos të futë në krevatin tuaj atë që urreni dhe mos të lejon të hyn në shtëpi atë që e urreni".

Hadithi është sabih, tra. Tirmidhiu.

Pra, mos të vjen keq ty oj grua muslimane, nëse burri ose babai yt të ndalon hyrjen e ndopnjë fqinjës së keqe në shtëpi, ngase sheh ndikimin e saj negativ në familje. Nëse ndodh që gruaja e fqiu të bën krahasime mes burrit të saj dhe burrit tënd, mos nxito që të kërkosh nga burri yt gjërat që nuk ka mundësi t'i realizon.

Megjithatë mos haro se edhe ti e ke për detyrë ta këshillosh burrin tënd, kur të shohish se ai shoqërohet me njerëz që ia zbukurojnë gjërat e këqija.

Dhuratë: Mundohu që të gjindesh në shtëpi në çdo rast që të jipet.

Prezenca e pronarit të shtëpisë në shtëpi i rregullon punët, gjithashtu mundëson edukimin, përmirësimin dhe përcjelljen e sjelljeve të anëtarëve të familjes. Disa njerëz mendojnë se çdo herë duhet dalë prej shtëpisë, e nëse nuk gjen ku të shkon, atëherë kthehet në shtëpi. Ky princip është i gabuar. Nëse një person del prej shtëpie për të vepruar vepra të mira dhe të vlefshme duhet barazpeshuar gjërat, kurse nëse dalja e tij është për të bërë mëkat, për të harxhuar kohën kot ose

për të punësuar veten me vepra të kësaj bote, atëherë duhet t'i pakëson punët dhe tregtinë e tij dhe t'i ndërpret takimet e kota.

Sa populli i keq janë ata njerëz që familjet e tyre shkatrohen kurse ata harxhojnë kohën në lozje.

Pastaj neve nuk kemi dëshirë që të veprojmë mu ashtu siç kanë planifikuar armiqtë e All-llahut. Në një broshurë të një klubi masonik francez "Lindja më e madhe" tregohen rezultatet e mbledhjes së mbajtur më 1923, ku në mes tjerash thuhet: Dëshira për të ndarë një person prej familjes së tij nuk mund të realizohet përveç se duke rrënuar moralin në bazë, ngase epshi anon kah ndërprerja e marëdhënjeve farefisnore dhe afrimi kah veprat e ndaluara, dhe i jep përparësi bisedave të kota në çajtoresh ndaj detyrave të tij ndaj familjes.

KËSHILLA E GJASHTËMBËDHJETË: DUHET QENË PRECIZ GJAT VËZHGIMIT TË GJENDJES SË ANTARËVE TË FAMILJES.

Cilët janë shokët e fëmijëve tuaj?

A je takuar dhe njohtuar me shokët e tyre?

Çka sjellin fëmijët në shtëpi nga jashtë?

A ke kontrolluar se ç'mbajnë në çantat dhe raftet e tyre, ç'ka mbajnë nën jastukët dhe krevatet e tyre?

Ku shkon vajza yte dhe me kend?

Disa prindër nuk dinë se fëmijët e tyre posedojnë fotografi të këqija, filma imoral, ndoshta edhe drogë! Ndosht që prindi të mos din se vajza e tij del në treg që të takohet me ndonjë shejtan, e tjetra shkon te ndonjë shoqe e keqë që të oinë së bashku duhan. Këta prind që i lënë të lirë fëmijët e tyre, nuk i kontrollojnë, nuk do të kalojnë pa marë në pyetje Ditën e Ringjalljes, e as që do të mund të ikin nga vështirësitë e kësaj dite.

Pejgamberi ? thotë:

“All-llahu i Lartësuar do ta pyet çdo bari (përgjegjës) për tufën që ka pasur nën përgjegjësinë e tij, a e ka ruajtur apo e ka humbur, derisa të pyetet njeriu për anëtarët e shtëpisë së vet”.

Hadithi është basen, tra. Ibni Hibbani.

Mirëpo gjat këtij vëzhgimi duhet pasur para sysh këto gjëra:

- a) Ky vëzhgim duhet të jetë i fshehur.
- b) Nën moton “Jo atmosferës së dhunës”.
- c) Nuk duhet të hetojnë fëmijët se prindërit e tyre dyshijnë në to.
- d) Gjat këshillimit ose denimit të fëmijëve duhet pasur parasysh vjetët e fëmijëve, aftësitë e tyre për të kuptuar dhe gradën e gabimit.

e) Largohuni precizitetit negativ dhe numrit të çdo frymëmarjes (dmth. përcjellje e çdo gjëje qoftë e vogël ose e madhe.)

Një person më ka treguar se një prind ka kompjuter dhe në te i regjistron gabimet e fëmijëve, me datë dhe hollësitë e ndodhisë, e nëse ndodh ndonjë gabim prej fëmijëve të tij, i thëret dhe i hapë fletën e tij ku gjinden të regjistruara të gjitha gabimet e tija, të hershmet dhe të tashmet.

Vërrejtje: Nuk është familja sipërmarje, e as që është prindi melek, i cili është përgjegjës për t'i shkruar gabimet. Ky prind duhet edhe më tepër të lexon mbi pedagogjinë Islame.

Nga ana tjetër i njoh disa njerëz që refuzojnë të ndërhyjnë në çështjet e fëmijëve të tyre, duke argumentuar këtë qëndrim të tyre se fëmiju nuk ka mundësi të bindet se kjo është gabim e ajo mëkat derisa nuk bjer në to, e pastaj të zbulon se kjo paska qenë gabim e kjo mëkat. Ky përfundim i gabuar buron prej burimeve të filozofisë perendimore të edukimit, e cila si bazë ka shfrenimin e njeriut nga çdo përgjegjësi. Disa tjerë nuk e kontrollojnë fëmijun duke menduar se po e kontrolloi fëmijun, ai do ta urren, e për këtë thotë: më mirë të fitoj dashurinë e tij e çka don le të bën. Disa tjerë i lëshojnë frerët e kontrollit ndaj fëmijëve të vet si rekon i përjetimit të keq me babain e tij, i cili ka ushtruar ashpërsi gjat edukimit të tij, dhe mendon se duhet vepruar në të kundërtën e asaj që ka vepruar prindi i tij me te. E ahmakllëku i disave arrin deri në atë gradë saqë thotë: lere djalin e vajzën le të kënaqen në rininë e tyre ashtu si dojnë ata. A nuk mendojnë këta njerëz se klëta fëmijë Ditën e Kijametit kanë për ti kapur për fyti dhe kanë për tu thonë: baba pse na le të bëjmë mëkate?!

KËSHILLA E SHTATËMBËDHJETË: DUHET DHËNË RËNDËSI FËMIJËVE TË VEGJËL NË SHTËPI.

Kjo temë mund të vështrohet në shumë aspekte:

1) Tua mësojmë përmendsh Kur’ani Kerimin dhe disa tregime Islame.

S’ka më mirë se t’i tubon prindi fëmijët e vegjël dhe tua mëson disa sure (kaptina) të vogla të Kur’anit, duke ua komentuar në mënyrë të lehtë, aq sa kuptojnë ata, e atyre që mësonjë përmendsh ndonjë surë tu ndan dhurata. Nëse prindi zakonisht ditën e Xhuma lexon suren El-Kehf, fëmija gjat dëgjimit të shpeshtë kësaj surejeje mund që ta mëson përmendsh. Tu mëson fëmijëve bazat e besimit Islam, si psh. bazat e besimit Islam që gjenden ne Hadithin e Abdull-llah ibn Abbasit radijall-llahu anhumu: “Ruajeni All-llahun (duke vepruar urdhërat e Tij dhe duke u larguar prej ndalesave të Tij), All-llahu të ruan ty”. Le tia mëson rregullat Islame, dhikrin e mëngjesit dhe mbrëmjes, dhikrin që duhet dhënë gjat ngrënies, gjat teshtisjes, rregullat e përsëritjes, hyrjes, etj. Kurse s’ka gjë që mund të ndikon tek fëmiju i vogël ashtu si ndikon tregimi Islam, siç është tregimi i Nuhit ?, i Tufanit (Vërshimi), tregimi i Ibrahimit ? gjat thyerjes së idhujve dhe gjuajtjes së tij në zjar, tregimi i Musait ? me Faraoni, tregimi i Junusit në bark të balenës, tregimi i Jusufit ? dhe tregimi i Pejgamberit ?, duke filluar prej pejgamberllëkut, shpërnguljes (hixhretit), duke i përmendur disa beteja më të rëndësishme që kanë ndodhur gjat jetës së tij, etj. Tregimi I disa njerëzve të mirë, siç është tregimi I Omerit radijall-llahu anhu me atë grua dhe fëmijët e saj të uritur, tregimi I njerëzve që janë gjuajtur në hendegje plot zjar, etj. Ua tregon këto tregime në mënyrë koncize dhe me disa komente të lehta, gjë me të cilën largohemi

prej përrallave që vijnë në kundërshtim me besimin Islam, legjendave dhe përrallave të trishtueshme që prishin realitetin fëmëinor e shkaktojnë frikë dhe tutë.

2) Të jesh i kujdesshëm e të mos lësh që fëmijët tu të shoqërohen me çdo kend, shoqëri e cila do tu mëson fjalë dhe moral të keq. Por mundohu që tu zgjedhish shok dhe shoqe me moral dhe vyrtyte fisnike.

3) Kujdesu që tu sjellish fëmijëve lojëra të dobishme. Bëru një dhomë ose një dollap ku do të vëndojnë lojërat e tyre, kurse largoi prej tyre lojërat që kundërshtohen me sheriatin Islam, siç janë lojërat muzikore, lojërat që kan kryq, etj. është mirë që të caktohet një vend për hobi të djemve, goftë ajo zdrukthtaria, elektronia, mekanikizmi, disa lojëra të lejuara të kompjuterit, etj. Në këtë rast ju tërheqim vërrejtjen prej disa disketave të kompjuterit që janë të programuara që të paraqesin fotografi të grave të çveshura lakuriq, ose lojëra në të cilat ka kryqe. Më kanë treguar disa njerëz se prej lojërave të kompjuterit është një lojë që është lojë kumari me kompjuterin. Në këtë lojë zgjedh një vajz prej katër vajzave që të paraqiten në monitor që të jet kundërshtari yt në këtë lojë, e nëse fiton në këtë lojë atëherë si shpërblim për fitimin e arritur paraqitet fotografia e vajzës e çveshur lakuriq.

4) Ndarja e djemve prej vajzave në shtratet e tyre, gjë me të cilën dallohen shtëpiat e njerëzve fetar prej atyre që si japin rëndësi parimeve fetare.

5) Përkdhelja e fëmijëve dhe të bërit shaka me to. Muhammedi ? bënte shaka me fëmijët, i përkdhelte kokat e tyre, kur ti thëriste i thëriste në mënyrë tërheqëse, frytet e para ua jipte fëmijëve, disa bile edhe i mbante në shpinë. Ja po u ofrojmë dy shembuj nga shakaja që bënte

Pejgamberi ? me nipërit e tij, Hasanin dhe Husejnin. Transmeton Ebu Hurejreja radijall-llahu anhu, i cili thotë:

“Ja tregonte Pejgamberi ? gjuën e tij Hasanit, birit të Aliut, e kur shifke fëmija të kuqën e gjuhës së tij vraponte kah ai i mahnitur”. Hadithi është sahih, tra. Ebu Shejhu në librin e tij “Ahlakun-Nebijji ve Adabuhu”. Kurse J’ala ibn Murrete thotë: “Dolëm më Pejgamberin ?,e në ndërkohë na thirën në ushqim (drekë). Duke ecur rrugës pamë Hasanin duke luajtur në rrugë, atëherë nxitoi Pejgamberi ? kah ai dhe i hapi krahët, kurse ai ikte në të djathtë e në të majtë dhe qeshej me Pejgamberin ?. E mori dhe me njëren dorë kapi nofullën e tij e me tjetrën kafkën e tij dhe e puthi”. Hadithi është sahih, tra. Buhariu në librin e tij “Edebul-Mufred”.

Kjo temë është e gjërë, ndoshta na jipet rasti që të flasim më gjërësisht mbi këtë në ndonjë broshurë të veçantë, me lejen e Zotit.

KËSHILLA E TETËMBËDHJETË: DUHESH TË JESH I PRERË NË RREGULLIMIN E KOHËS SË GJUMIT DHE DETYRAVE.

Disa shtëpi janë porsì hotel, anëtarët e saj për pak mos të njohin njëri tjetrin dhe shumë pak takohen. Disa fëmijë hanë kur të duan, flejnë kur duan, mbeten deri vonë natën pa gjumë, humbin kohën, kështuqë prishet renditja e ushqimit dhe gjumit. Ky kaos shkakton prishjen e

marëdhënjeve mes anëtarëve të familjes, harxhimin e energjisë dhe kohës, gjithashtu zmadhohet ç'rregullsia tek anëtarët e familjes. Mund që të pranojmë arsye prej disa personave, siç janë nxënësit dhe studentët, të cilët dalin prej shkollave dhe univerziteteve në kohë të caktuar, meshkujt qofshin ose femra. E njëjta vlen edhe për puntorët dhe nëpunësit, te të cilët kohëzgjatja e punës nuk është e njëjtë. Mirëpo kjo gjendje nuk është tek të gjithë.

S'ka më ëmbël se tubimi i gjith familjes gjat ushqimit, rast i cili mund të shfritëzohet për të njoftë gjendjen e antarëve të familjes dhe për të bërë diskutime të dobishme. Për këtë pronari i shtëpisë duhet të jetë i prerë në rregullimin e kthimit në shtëpi dhe të kërkimit leje gjat daljes, sidomos për të vegjëlit, për të cilët frikohemi që të mos të devijonë.

KËSHILLA E NËNTËMBËDHJETË: VLERËSIMI I PUNËSIMIT TË GRUAS JASHTË SHTËPISË.

Dispozitat e islamit e plotësojnë njëra tjetrën. Allahu xhel-le .shanuhu kur i urdhëron gratë duke thënë:

“Dhe rrini në shtëpitë tuaja”

(Abzab: 33)

bëri që kush ti furnizon ato meodomos siç është prindi dhe burri.

Në esencë gruaja nuk duhet të punon jashtë shtëpisë, përveçse nëse ka nevojë, siç pa Musai ? dy vajzat e njeriut të mirë duke pritë që tu japin ujë kafshëve dhe i pyeti:

“E çka është puna e juve dyve? Ato që të dyja thanë: “Ne nuk u japim ujë deri të largohen barinjët, kurse babai ynë është shumë i vjetër!”

(Kasas:23)

Pra u arsyetuan për daljen e tyre për tu dhënë ujë bagëtisë me faktin se përgjegjësi i tyre ishte shumë i vjetër dhe nuk mund të punon. Mirëpo për këtë ato shfrytëzonin çdo rast për të shpëtuar prej punës së tyre jashtë shtëpisë. Për këtë edhe iu drejtuan babait të tyre:

“Njëra prej atyre dyjave tha: “O babi im, merre këtë në shërbim me pagë, pse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishëm, e besniku!”

(Kasas: 26)

Pra kjo grua shrpehu dëshirën e saj që të kthehet në shtëpi për të mbrojtur vetveten nga dëmi që mund ti ndodh duke punuar jashtë shtëpisë.

Kur u paraqitë nevoja për punësimin e gruas tek jobesimtarët në këtë shekull, pas dy luftave botërore, për të plotësuar mungesën e burrave dhe për të përmirësuar atë që shkatërroj lufta, gjë të cilën e pasoj plani çifut mbi emancipimin e gruas dhe thirrja për të drejtat e tyre, me qëllim që të prishë gruan, e pastaj automatikisht edhe gjithë shoqërinë, doli në shesh problemi i punësimit të gruas.

Edhe pse nxitjet që ishin tek ata nuk janë edhe tek neve, ngase individi musliman mbron gruan dhe vajzat e tij dhe i furnizon, mirëpo lëvizja për emancipimin e gruas u përhap, gjërsa edhe

filluan që të kërkohet dërgimi i tyre jashtë për të studiuar, që pastaj të kërkohet punësimin e tyre, me qëllim që diploma e saj të mos jetë e kotë. Mirëpo shoqëria Islame nuk ka nevojë për këtë çështje, në këtë formë të gjërë. Argument për këtë është ekzistimi i një numri të madh të burrave pa punë edhe pse edhe më tej hapen vende pune për gratë.

Kur themi: “në këtë formë të gjërë” kemi për qëllim se kemi nevojë për punësimin e gruas në disa drejtime, siç është arsimi, mjekësia, mirëpo me kushte të shariatit. Mirëpo e dhamë këtë hyrje ngase kemi parë se disa gra dalin për të punuar pa nevojë, bile në disa raste për rroga të vogla, duke u nisur prej ndjenjës se meodomas duhet të dalë të punon edhe pse s’ka nevojë, edhe ate në vende që si takon asaj. Andaj ndodhën çorodi të mëdha.

Dallimi kryesor ndërmjet metodës islame dhe metodës sekulariste, sa i takon çështjes së “emancipimit” të gruas, është se islami esencë të kësaj çështje e konsideron ajetin “Dhe rrini në shtëpitë tuaja” (Ahzab: 33), e lejon daljen prej shtëpisë për nevojë:

“U është lejuar të dilni (prej shtëpiave tuaja) për nevojat tuaja”. Kurse metoda sekulariste përkrah teorinë se dalja e gruas në punë është esencë në çdo rast.

Për të qenë të drejtë në fjalë themi: në disa raste punësimi i gruas është nevojë, mund që gruaja të jetë bartësi i familjes pas vdekjes së burrit, ose prindi të jetë i pamundshëm etj. Bile në disa vende, si rezultat i mosekzistimit të shoqërisë së bazuar në baza islame, detyrohet gruaja të punon së bashku me burrin që të mund ti mbulojë harxhimet e shtëpisë. Në këto shoqëri ndodh që edhe mos të martohet vajza e papunësuar, bile disa në kontratën e fejesës kanë kushtëzuar gruas që të punon.

Përfundojmë këtë temë duke thënë se punësimi i gruas mund të jetë për nevojë, për qëllim islam, siç është daveti (thirja) në sferat e arsimit ose për zbavitje për ato gra që nuk kanë fëmijë.

Sa i përket negativitetit të punësimit të gruas, ato janë:

1) Ndodhja e shumë veprave të këqija, siç është përzierja me burrat, njoftimi dhe vetmimi me ta, parfymosja për ta, shfaqja e zbukurimeve njerëzve të huaj. E fund i gjithë kësaj mund të jetë amoraliteti.

2) Mos dhënja rëndësi familjes, burrit, fëmijëve dhe shtëpisë (kjo është edhe tema jonë).

3) Nga kjo rezulton fakti se disa gra nuk ndiejnë se burrat janë përgjegjës për to. Paramendo gruaja të ketë diplomë si të burrit ose më të lartë (gjë e cila nuk është e metë në vetë), të punon dhe të merr rrogë më të madhe se të burrit. A thua vallë kjo grua do të ndien se ka nevojë për burrin e saj ose ndodh që ndjenja se është e panevojshme për të tjerët mund të shkakton dridhje të fortifikatës së shtëpisë. Këto janë probleme që edhe nuk mbarojnë.

4) Lodhja trupore, presioni psiqik dhe nervoza, gjëra që nuk përkojnë me natyrën e gruas.

Pas këtij ekspozimi konçiz të dobive dhe të dëmeve të punësimit të gruas themi: medoemos duhet të posedohet devotshmëri dhe të peshohen sendet në peshojë të sheriatit që të dihet kur mundet të del gruaja të punon dhe kur nuk lejohet të del të punon. Pastaj nuk duhet të na verbërojnë fitimet e kësaj bote nga pasimi i rrugës së vërtetë. Për këtë shkak këshilloj gruan muslimane të jetë e devotshme dhe të respekton burrin nëse ai kërkon prej saj që të len punën për

të mirë të shtëpisë dhe për të mirë të saj, kurse burri duhet të mos i hakmirret dhe të mos han pronën e gruas së tij pa të drejtë.

KËSHILLA E NJËZET: MBANE SEKRETIN E SHTËPISË

Kjo këshillë kaplon disa pika:

- 1) Mospërhapja e sekreteve të kënaqësive epshore mes dy bashkëshortëve.
- 2) Nuk duhet nxjerrë jashtë mospajtimet që ndodhin mes dy bashkëshortëve.
- 3) Nuk duhet zbuluar asnjë send që me zbulimin e tij i bëhet dëm shtëpisë ose ndonjë antari të saj.

- Argument për ndalimin e pikës së parë është fjala e Pejgamberit ?:

“Njeriu me pozitë më të keqe tek All-llahu Ditën e kijametit është ai që bën marrdhënje me gruan e tij, pastaj e përhapë këtë sekret”. Tra. Muslimi. Kurse tregon Esmaja bija e Jezidit, e cila ka qenë bashkë me disa burra dhe disa gra në prani të Pejgamberit ?, i cili u ka thënë:

“A ndodh që ndonjë burrë të tregon se ç’bën me gruan e tij, ose të tregon ndonjë grua se ç’bën me burrin e saj”. Në këtë rast heshtën të gjithë. (Esmaja) Tha: Po o Rresulull-llab, ata e veprojnë këtë vepër. Tha (Pejgamberi ?):

“Mos e bëni këtë vepër ngase kjo i përngjanë shejtanit i cili e takon një shejtane në rrugë e bën me të marrdhënje në prezencë të njerëzve”. Hadithi është sahih, tra. Imam Ahmedi. Në transmetimin e Ebu Davudit qëndron: “A ka ndokush prej jush që kur bën marrdhënje me gruan e tij, e mbyll derën dhe mbulohet me mbulesë të Allahut? Thanë: po. Mirëpo pastaj ulet dhe u tregon njerëzve, kam bërë këtë e këtë. (Ata) heshtën. Pastaj iu drejtua grave dhe u tha: “A e bën këtë ndokush prej jush? Edhe ato heshtën. Një vajzë u ngrit në gishta dhe u zgjat për ta dëgjuar dhe për ta parë Resulull-llahu ?, dhe tha: O Resulull-llah ata e bëjnë këtë vepër. (Resulull-llahu) Tha: “A e dini ç’është shembulli i kësaj? Shembulli i kësaj është sikur shembulli i shejtanit i cili e takon shejtanen në rrugë, bën marrdhënje me të, e njerëzit i shikojnë”. Hadithi është sahih, tra. Ebu Davudi.

- Sa i takon pikës së dytë, që është tregimi i përcarjeve bashkëshortore jashta rrethit familjar, në të shumtën e rasteve e koklavit problemin edhe më tepër. Gjithashtu ndërhyrja e palëve të jashtme në mosmarrveshjet bashkëshortore në të shumtën e rasteve e acaron edhe më tepër problemin. Kurse zgjedhja e problemit, nëse nuk ka mundësi të pajtohen pa ndërhyrje, është ndërhyrja e dy personave që janë më të afërt të tyre, domethënë veprojnë ashtu siç ka thënë Allahu:

“Dërgoni një pari të drejtë nga familja e tij dhe një pari të drejtë nga familja e saj. Nëse ata të dy (ndërmjetësuesit) kanë për qëllim pajtimin, Allahu ju mundëson afrimin mes tyre. (burrit dhe gruas)”.

(Nisa: 35)

- Pika e tretë: Kjo vepër i bën dëm shtëpisë ose ndonjë antarit të shtëpisë dhe për këtë shkak nuk lejohet. Pejgamberi ? thotë:

“Nuk ka dëm as të dëmtuar (reciprok)”. Hadithi është sahih, tra. Imam Ahmedî. ýPrej këtyre shembujve është ajo që është përmendur gjat komentit të ajetit:

“Atyre që mohuan, Allahu u sjell shembuj gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato ishin kurorë e të dy robërve të mirë nga robërit tanë, por ato të dyja i tradhtuan (në fe) ata të dy...”

(*Tabrim: 10*)

Transmeton Ibn Kethiri gjatë komentit të këtij ajeti këtë që vijon: “Gruaja e Nuhut kuptonte sekretet e Nuhut dhe kur pranonte fenë ndonjë tjetër, ajo i tregonte mbretërve të popullit të Nuhut, kurse sa i takon gruas së Lutit, ajo kur vinte ndonjë musafir tek Luti, i lajmëronte njerëzit e këqinj në qytet” (që të bëjnë amoralitet me ta).

MORALI NË SHTËPI **KËSHILLA E NJËZETENJË:** **PËRHAPJA E BUTËSISË NË SHTËPI.**

Transmeton Aisheja r.a. nga Pejgamberi ?, i cili thotë:

“Nëse Allahu don të mirën e e një shtëpie e fut në butësinë”.

Hadithi është sahih, tra. Imam Ahmedî, kurse në transmetimin tjetër qëndron:

“Nëse Allahu don një familje futë tek ata butësinë”.

Hadithi është sahih, tra. Ibn Ebu Dunja.

Domethënë sjellën butë njëri me tjetrin. Kjo është prej faktorëve të lumturisë në shtëpi. Pra, butësia është e dobishme ndërmjet bashkëshortëve, ndërmjet fëmijëve, ndërmjet fëmijëve e prindërve dhe sjell rezultate që nuk mund t'i sjell ashpërsia. Pejgamberi ? thotë:

“Allahu don butësinë, dhe jep në butësi atë që nuk jep as në ashpërsi e as në sjellet tjera”.

Tra. Muslimi

KËSHILLA E NJËZET E DY: BASHKËPUNIMI NDËRMJET ANTARËVE TË FAMIJES

Shumica e burrave urrejnë punën e shtëpisë, bile disa besojnë se kjo vepër ua zvoglon vlerën dhe pozitën e tyre. Kurse sa i takon Pejgamberit ?, ai “ka qepë rrobat e tij, arrnonte këpucët, nallanet dhe bënte atë që bëjnë burrat në shtëpi” . Hadithi është sahih, tra. Imam Ahmedi

Këtë e ka thënë gruaja e tij, Aisheja r.a., pasi që është pyet se çka ka vepruar Pejgamberi ? në shtëpi. Pra është përgjigjë me atë që ka parë. Kurse në transmetimin tjetër qëndron:

“Ishte njëri prej njerëzve, pastronte rrobat e tij, milte delen e tij dhe shërbente vetveten”.

Hadithi është sahih, tra. Imam Ahmedi.

Gjithashtu është pyetur Aisheja r.a. se çka ka vepruar Pejgamberi s.a.v.s në shtëpi? Është përgjigjur: “Shërbente familjen e tij, kurse kur vinte koha e namazit, dilte për ta falë namazin”. Tra. Buhariu.

Po të bënim këtë ne sot do të realizonim këto dobi:

- 1) Pasojmë Pejgamberin ? .
- 2) Ndhimojmë familjen tonë.
- 3) Ndiemi modest dhe jo kryelartë.

Disa burra kërkojnë prej grave të tyre ushqimin në të shpejtë, kurse ushqimi është në zjarr, e fëmija qanë dhe kërkon qumësht, e ky as që mban fëmijën, e as që pret pak. Pra le të jenë këto hadithe përkujtim dhe mësim për këtë lloj të burrave.

KËSHILLA E NJËZET E TRETË: PËRKDHSELJA DHE BËRJA SHAKA ME ANTARËT E FAMILJES

Përkdhelja e bashkëshortes dhe e fëmijeve është faktor i përhapjes së lumturisë dhe dashurisë në shtëpi. Për këtë shkak Muhammedi ? këshilloj Xhabirin r.a. që të marton vajzë beqare duke thënë:

“Marto beqaren, me të cilën luan dhe ajo luan me ty, qeshesh me të dhe ajo qeshet me ty”.

Tra. Bubarin

Dhe thotë:

“Çdo send në të cilën nuk përmendet Zoti është lojë dhe zëbavitje (humbje kohe) përveç se në katër gjëra: luajtja e burrit me gruan e tij...”

Hadithi është sabih, tra. Nesaiu në librin “Usbretun-Nisa”.

Pejgamberi ? përkdhelte gruane e tij, Aishen, duke u larë me të, siç thotë Aisheja r.a.:

“Labesha me Pejgamberin ? prej një ene, e mxitonte dhe nxirrte ujë para mua, kurse unë i thosha lere për mua, lere për mua. Tha: dhe të dy ishim xhunub”.

Tra. Muslimi.

Sa i takon përkdheljes së Pejgamberit ? fëmijëve, kjo çështje është e njohur. Shpesh herë përkdhelte Hasanin dhe Husejnin, siç përmendëm më parë. Ndoshta kjo ka qenë prej shkaqeve të gëzimit të fëmijëve gjatë ardhjes së Pejgamberit ? prej udhëtimit, ku nxitonin të takojnë Pejgamberin ? , siç transmetohet në hadith të vërtetë: “Kur kthehej prej udhëtimit takohej më fëmijët e familjes”. Tra. Muslimi.

Pejgamberi ? i përqafonte fëmijët, siç transmeton Abdullah ibn Xhaferi r.a.:

“Kur kthehej Pejgamberi ? prej udhëtimit takohej me mua, Hasanin ose Husejnin. Njerin e mbante në duar, kurse tjetrin në shpinë derisa hynim në Medinë”.

Tra. Muslimi.

Krahaso këtë me gjendjen e shumë shtëpive në të cilat nuk ka shaka, as përkdhelje e as mëshirë. Ndaj, ai që mendon se puthja e fëmijëve nuk përputhet me burrërinë e prindit le të lexon këtë hadith: Ebu Hurejra r.a thotë:

“Pejgamberi ? puthi Hasanin birin e Aliut r.a. në prezencë të El-Ekre’ bin Habis et-Teminit. El-Ekreu’ tha: Unë i kam dhjetë fëmijë, asnjërin prej tyre nuk e kam puthë. Pejgamberi ? e shiqoi, pastaj tha:

“Ai që nuk mëshiron nuk Mëshirohet”.

Tra. Buhariu.

KËSHILLA E NJËZET E KATËRT: DUHET BËRË REZISTENCË NDAJ MORALIT TË KEQ NË SHTËPI

Rrallë herë mund të ketë persona që nuk janë të cilësuar me moral të keq, siç është gënjeshtria, gibeti, bartja e fjalëve etj. Për këtë shkak duhet bërë medoemos rezistencë ndaj këtyre cilësive negative.

Disa mendojnë se dënimi trupor është ilaçi i vetëm në këto raste. Mirëpo nga hadithi që do të citojmë më poshtë do të kuptojmë se kjo nuk është ashtu. Aisheja r.a. thotë:

“Pejgamberi ?, nëse shihte tek ndonjë antar i familjes ndonjë gënjeshtër, largohej prej tij deri sa të bënte teube (pendohej)”. Hadithi është sahih, tra. Imam Ahmedi.

Nga ky hadith kuptojmë se largimi, mosbisedimi dhe mosndodhja afër tij është dënim i madh në këtë rast, ndoshta me efekt më të madh se dënimi trupor. Pra le të kuptojnë këtë gjë edukatorët (prindërit) në shtëpi.

KËSHILLA E NJËZET E PESTË: VËNDO SHKOPIN NË ATË VEND QË E SHOHIN ANTARËT E FAMIJLES.

Dhënja shenjë për dënim është mjet mjaft edukativ. Për këtë shkak është sqaruar shkaku i vërjes së shkopit në shtëpi, siç qëndron në transmetimin tjetër, ku Muhammedi ? thotë:

“Vareni shkopin në vend ku e shohin antarët e familjes, ngase kjo është edukatë për ta”.

Hadithi është sahih, tra. Taberanin.

Shikimi i mjetit të dënimit, ata të cilët kanë qëllime të këqija, i bën të ç’veshen nga rrobat e jomoralit, duke u frikë nga dënimi dhe i nxitë të jenë të edukuar dhe të moralshëm. Ibnul-Enbari thotë: “Nuk ka pasë për qëllim (me këtë hadith), rrahjen, ngase nuk ka urdhëruar, por ka pasë qëllim edukimin e tyre”.

Rrahja asnjëher nuk është esencë, dhe nuk lejohet shfrytëzimi i këtij mjeti nëse nuk i ke përdorur të gjitha mjetet tjera edukative.

Allahu xh.sh thotë:

“E ato që u keni dro kryelartësisë së tyre, këshilloni, madje largoni nga shtrati (e më në fund), edhe rrahni (lehtë, nëse nuk ndikojnë këshillat as largimi)”.

(Nisa: 34)

Gjat përdorimit të këtyre masave edukuese duhet pasë parasysh renditjen. Kurse Pejgamberi ? thotë:

“Urdhëroni fëmijët e juaj të falin namaz kur ti mbushin shtatë vjet, kurse rrahni (nëse e lënë namazin) kur ti mbushin dhjetë vjet”.

Hadithi është sahih, tra. Ebu Davudi.

Përdorimi i rrahjes pa nevojë është kalim i kufijve dhe mizori, kurse “Pejgamberi ? ka porositur një grua që të mos martohet me filan burrin ngase ai shumë e përdorë shkopin”, dmth i rreh shumë gratë. Mirëpo ai që mendon se nuk duhet përdorur rrahja asnjëherë, duke u bazuar në metodologjinë e jobesimtarëve në edukatë, është në gabim dhe bjer në kundërshtim me tekstet e shariatit.

VEPRAT E NDALUARA NË SHTËPI

KËSHILLA E NJËZET E GJASHTË:

**HYRJA E TË AFËRMËVE QË NUK JANË MAHREM NË SHTËPI KUR
NUK ËSHTË BURRI ATY.**

KËSHILLA E NJËZET E SHTATË:

NDANI GRATË PREJ BURRAVE GJAT VIZITAVE FAMILJARE.

KËSHILLA E NJËZET E TETË:

**KENI KUJDES PREJ REZIKUT TË VOZITËSIT DHE SHËRBËTORËVE NË
SHTËPI.**

KËSHILLA E NJËZET E NËNTË:

NXJERRNI HEMAFRODITËT PREJ SHTËPIE.

KËSHILLA E TRIDHJETË:

RUHUNI NGA DËMI I TELEVIZORIT.

KËSHILLA E TRIDHJETË E NJË:
RUHUNI PREJ DËMIT TË TELEFONIT.

KËSHILLA E TRIDHJETË E DYTË:
**DUHET NXJERRË PREJ SHTËPISË TË GJITHA SHENJAT E BESIMEVE
TJERA DHE TË ZOTAVE TË TYRE.**

KËSHILLA E TRIDHJETË E TRETË:
NXJERRNI FOTOGRAFITË E GJËRAVE QË KANË SHPIRTË.

KËSHILLA E TRIDHJETË E KATËRT:
NDALNI PIRJEN E DUHANIT NË SHTËPIT TUAJA.

KËSHILLA E TRIDHJETË E PESË:
MOS MBANI QEN NË SHTËPI.

KËSHILLA E TRIDHJETË E GJASHTË: LARGOHUNI NGA ZBUKURIMI I TEPËRT I SHTËPIVE.

RREGULLIMI I SHTËPISË NGA BRENDA DHE JASHTË KËSHILLA E TRIDHJET E SHTATË: DUHET ZGJEDHË VEND DHE PROJEKT TË MIRË PËR SHTËPINË.

Pa dyshim muslimani i vërtetë, gjat zgjedhjes së shtëpisë dhe projektit të saj, ka parasysh këto pika:

- 1) Të jetë shtëpia afër xhamisë. Në këtë vepër ka dobi të mëdha. Ezani ia përkujton namazin dhe e zgjon për në namaz. Afërsia e xhamisë të mëdhenjëve u mundëson që çdo namaz të falin me xhemat, e fëmijëve të marrin pjesë në mësim-besim, ku do të mësojnë pjesë të Kur'anit përmendsh dhe parimet e besimit Islam.
- 2) Të mos jetë banesa në ndërtesë, në të cilën jetojnë njerëz të prishur moralisht ose jobesimtarë.
- 3) Mbulimi i dritareve, në ç'mënyrë nuk do të shihet mbrendësia e dhomës prej fqijut, ose njeriut prej në rrugë, sidomos natën kur ndezen llambat.
- 4) Të bëhen hyrje të veçantë për gratë dhe dhoma të ndejes veçmas për burrat dhe veçmas për gratë, e nëse nuk ka mundësi, atëherë le të bëhen këtë ndarje me perde ose diç tjetër.
- 5) Mos të jenë nevojtoret në drejtim të kibles gjat përdorimit të tyre.

6) Të zgjedhet banesë të gjërë dhe (me komoditet) për shumë shkaqe:

a) “Allahu xh.sh don që të sheh tregjet e nimeteve (dhuntive) të Tij në robin e Tij”. Hadithi është sahih, tra. Tirmidhiu.

b) “Tre gjëra janë prej lumturisë së një personi dhe tre gjëra janë prej mjerimit të një personi. Prej lumturisë janë: gruaja e mirë, kur e sheh të pëlqen dhe nëse largohesh prej saj, je i sigurtë për të dhe për pasurinë tënde, kafsha e shpejtë e cila të takon me shokët tuaj dhe shtëpia, e cila është e gjërë dhe me shumë komoditet, kurse prej mjerimit janë: gruaja e keqe, kur ta shohish të neveritë dhe flet kundër teje, dhe nëse largohesh prej saj nuk je i sigurtë për te dhe për pasurinë tënde dhe kafsha, e cila është e ngadalshme, nëse i bjer e lodhë, kurse nëse e len nuk mund të takon me shokët e tij dhe shtëpia e cila nuk ka shumë komoditet”. Hadithi është sahih, tra. Hakimi.

c) T’i japim rëndësi çështjeve shëndetsore, siç është ajrosja, hyrja e rrezeve të diellit dhe çështjeve tjera, normalisht sipas mundësive materiale.

KËSHILLA E TRIDHJETË E TETË: ZGJIDHE FQIUN PARA SHTËPISË.

Një broshurë e tërë mund të veçohet mbi këtë temë, nga rëndësia e madhe e kësaj teme.

Fqiu në këtë shekull ndikon shumë në fqin e tij, nga shkaku i afrimit të banesave dhe bashkimit të njerëzve në ndërtesa dhe banesa.

Muhammedi ? na lajmëron për katër gjëra, të cilat janë prej lumturisë së njeriut, prej tyre është “fqiu i mirë”, gjithashtu lajmëroi katër gjëra prej mjerimit të njeriut dhe përmendi “fqiu e keq”. Hadithi është sahih, tra. Ebu Nua’jmi në “El-Hilje”.

Nga shkaku i rrezikut të këtij të fundit, Pejgamberi ? kërkonte mbështetje tek Zoti nga ky duke thënë:

“O Zot, unë kërkojë mbështetje prej Teje nga fqiu i keq në (vend - qytet të palëvizshëm), ngase fqiu nomad (bedevij) mund të transportohet”. Hadithi është sahih, tra. Hakimi. Dhe urdhëroi muslimanët që të kërkojnë mbështetje tek Zoti nga kjo gjë duke thënë: “Kërkoni mbështetje tek Zoti nga fqiu i keq në qytet (vend të palëvizshëm), ngase fqiu nomad (bedevij) mund të transportohet”.

Tra. Buhariu.

Nuk na lejon vendi që të flasim mbi ndikimin e fqiu të keq mbi bashkëshortët dhe fëmijët dhe llojet e dëmeve që dalin prej tij. Mirëpo praktikimi i këtyre haditheve është mësim i mjaftueshëm mbi këtë temë. Ndoshta prej zgjedhjeve praktike është ajo që veprojnë disa burra të mirë, të cilët i marrin me qira edhe banesat rreth shtëpiave të tyre për të afërmit e tyre, për të zgjedhë problemin e fqiu, edhe pse shkon në dëm të mundësive materiale, ngase fqiu i mirë nuk vlerësohet me pasuri.

KËSHILLA E TRIDHJETË E NËNTË: DUHET DHËNË RËNDËSI PËRMIRËSIMEVE TË NEVOJSHME NË SHTËPI DHE OFRIMIT TË MJETEVE TË REHATISË NË SHTËPI.

Prej begative të Allahut ndaj neve në këtë kohë është ofrimi I këtyre mjeteve të rehatisë, mjeteve që na e lëhtësojnë jetën në këtë botë dhe na shpenzojnë kohën, siç është pajimi klimatik, frigoriferi, petkalarëseja etj. Mençuri është sjellja e këtyre mjeteve në shtëpi me kualitet sa më të mirë, normalish sipas mundësive materiale të pronarit të shtëpisë. Mirëpo medoemos duhet të dallojmë ndërmjet çështjeve të dobishme përmirësuese dhe çështjeve që s'kanë vlerë.

Duhet përmirësuar pajimet e komoditetit nëse ato prishen. Disa njerëz këto vepra i lënë pas dore saqë gratë e tyre ankohen nga ç'rregullimi i shtëpisë, ku mbushet shtëpia me erë të gjubreve, paraqiten lloj-lloj insektesh, kurse pjesët e mobiljeve të thyera i gjen në çdo vend.

S'ka dyshim se këto gjëra menjanojnë lumturinë në këtë shtëpi dhe shkaktojnë probleme familjare e shëndetsore, kurse i mençur është ai që i shëron këto negativitete.

KËSHILLA E KATËRDHJETË: DUHET DHËNË RËNDËSI SHËNDETIT TË ANTARËVE TË FAMILJES.

Pejgamberi ? “fryente duke lexuar Muavedhatet (suren Ihlas, Felek dhe Nas) në antarët e sëmurë të familjes”.Tra. Muslimi.

Gjithashtu “Kur sëmurëj ndonjë antarë i familjes, Pejgamberi ? urdhëronte të bëhet çorbë, pastaj urdhëronte që të pinë nga kjo çorbë. Dhe thoshte “Kjo përforcon zemrën e të dëshpëruarit dhe largon sëmundjen nga zemra, ashtu siç largon çdo kush prej juve papastërtinë nga fytyra e saj”. Hadithi është sahih, tra. Tirmidhiu.

Disa masa preventive:

Pejgamberi ? thotë:

“Në mbrëmje ndalni fëmijët (në shtëpi) ngase shejtanët në atë kohë përhapen, e pasi të kalon kjo kohë leni të lirë, mbyllni dyert duke përmendur Emrin e Zotit, mbuloni enet e juaja duke përmendur Emrin e Zotit, e nëse nuk keni me çka, atëherë vëndoni diç (siç është një degë) dhe fikni llambat”.

Tra. Buharin.

Në transmetimin e Muslimit qëndron:

“Mbyllni dyert, mbuloni enët, fikni llambat, mbuloni ibrigët, ngase shejtani nuk hap derë të mbyllur, nuk shpallon mbulesën dhe nuk hapë kapakun, kurse miu mund të ndezë shtëpinë (duke kapë fitilin dhe ndezë gjithë shtëpinë)”.

Pejgamberi ? thotë:

“Mos e leni zjarrin (ndezur) në shtëpi kur të fleni”.

Tra. Buhariu.